

# RAPORT

---

**MBI EFEKTET E ZBATIMIT TË SKEMËS  
SË VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR  
BAZUAR NË MODELIN BIO-PSIKO-SOCIAL**



**MARS 2026**



## Të drejtat e autorit ©Shoqata Together for Life

Ky raport është publikuar nga **Shoqata Together for Life** në kuadër të **Programit të Mbështetjes Bazë (Core Support Programme)**, i financuar nga **Ambasada e Suedisë në Tiranë**. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e organizatës Together for Life dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Ambasadës së Suedisë në Tiranë.

*Shënim për perktimin:*

*Ky dokument është përgatitur fillimisht në gjuhën angleze nga ekspertët e fushës dhe është miratuar nga TFL. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet versionit në gjuhën angleze dhe perktimit në ndonjë gjuhë tjetër, do të ketë përparësi versioni në gjuhën angleze.*

### **Autorët:**

Dr. Holtjana Bello - *Drejtues i Ekipit dhe Ekspert i Dokumentit të Politikave*

Elvis Zerva - *Ekspert Ligjor*

Eva Mertiri - *Eksperte Financiare*

© TOGETHER FOR LIFE

Rr. Brigada VIII, Tiranë, Shqipëri

Email: [info@togetherforlife.org.al](mailto:info@togetherforlife.org.al)

Web: [www.togetherforlife.org.al](http://www.togetherforlife.org.al)

# Përmbajtja



<b>Përmbledhje ekzekutive.....</b>	<b>07</b>
• Përmbledhje e gjetjeve kryesore sipas tematikës.....	09
• Përmbledhje e rekomandimeve.....	12
<b>Hyrje.....</b>	<b>17</b>
• Objektivat dhe fusha e punës.....	21
• Metodologjia.....	22
<b>I. Pjesa 1.....</b>	<b>26</b>
1. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore ekonomike dhe ligjore.....	26
2. Rekomandimet e përgjithshme.....	48
<b>II. Pjesa 2.....</b>	<b>49</b>
• Gjetjet dhe rekomandimet kryesore financiare.....	49
• Analiza financiare.....	53
<b>Anekset.....</b>	<b>85</b>
• Kuadri ligjor - Konteksti dhe Analiza.....	85
<b>Referencat .....</b>	<b>100</b>

# Tabelat dhe grafikët



<b>Tabela 1:</b> Numri i intervistave gjysmë të strukturuar.....	23
<b>Tabela 2:</b> Inspektorati i Punës - Punësimi i personave me aftësi të kufizuara.....	40
<b>Tabela 3:</b> AKPA- Punësimi i personave me aftësi të kufizuara.....	40
<b>Tabela 4:</b> Kostoja e Qëllimeve të Planit të veprimt të PAK.....	54
<b>Tabela 5:</b> Fondet e shpenzuara nga buxheti i shtetit për periudhën 2019-2024 për kategorinë PAK.....	55
<b>Tabela 6:</b> Numri i përfituesve PAK dhe kujdestarëve & fondet buxhetore 2019-2028....	56
<b>Tabela 7:</b> Numri mesatar i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë pagesë paaftësie dhe shërbim kujdestarie, 2019-2023.....	57
<b>Tabela 8:</b> Numri i shërbimeve të integruara dhe fondet buxhetore të shpenzuara për periudhën 2020-2024.....	63
<b>Tabela 9:</b> Përfitues PAK të shërbimeve të përkujdesit social të ofruar në qendrat rezidenciale publike dhe fondet buxhetore të shpenzuar dhe planifikuara përgjatë 2022-2028 në lekë.....	65
<b>Tabela 10:</b> Përfitues të shërbimeve në institucionet e përkujdesit shoqëror sipas kategorive.....	66
<b>Tabela 11:</b> Shpenzimet buxhetore të produktit “Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale”.....	71
<b>Tabela 12:</b> Statistika të numrit të nxënësve me AK dhe mësuesve ndihmës në shkollat publike.....	74
<b>Tabela 13:</b> Shpenzimet për nxënësit me aftësi të vecanta në Qendrat Burimore 2019-2028 .....	75
<b>Tabela 14:</b> Shpenzime për fëmijët në nevojë dhe nxënësit që përfitojnë tekste shkollore falas 2019-2028.....	76
<b>Tabela 15:</b> Statistika të numrit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar sipas nivelit arsimor dhe gjinisë.....	78
<b>Tabela 16:</b> Punëkërkuesit përfitues nga programet e nxitjes së punësimit dhe fondet buxhetore të shpenzuara .....	79
<b>Tabela 17:</b> Fondet e shpenzuara nga buxheti i shtetit për kategoritë PAK.....	79



---

<b>Tabela 18:</b> Punëkërkesit që përfitojnë nga programet e formimit profesional.....	80
<b>Tabela 19:</b> Objektivi 1 dhe kostoja e tij.....	81
<b>Tabela 20:</b> Buxheti i shpenzuar dhe planifikuar për periudhën 2019-2028 për Ndihmën Juridike.....	83
<b>Tabela 21:</b> Përputhja e parimeve të Konventës me të drejtat kushtetuese në Shqipëri.....	87
<b>Grafiku 1:</b> Si ndiheni në lidhje me komunikimin me profesionistët e shëndetësisë?..	30
<b>Grafiku 2:</b> Mjaftueshmëria e burimeve financiare.....	33
<b>Grafiku 3:</b> Standardizimi i manualeve dhe udhëzimi mbi vlerësimin biopsikosocial..	35
<b>Grafiku 4:</b> Cilën pjesë të vlerësimit e konsideroni më sfiduese?.....	38
<b>Grafiku 5:</b> A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim mbi modelin psikosocial?.....	38
<b>Grafiku 6:</b> AKPA- Punësimi i personave me aftësi të kufizuara.....	41
<b>Grafiku 7:</b> Rastet që kanë marrë ndihmë ligjore falas.....	45
<b>Grafiku 8:</b> Përpjesa e përfituesve sipas kategorisë së paaftësisë.....	57

# Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport ofron një analizë të plotë të qasjes bio-psiko-sociale për personat me aftësi të kufizuara dhe efekteve të saj, pas shqetësimeve të ngritura nga vetë personat me aftësi të kufizuara mbi efektivitetin e zbatimit të saj. Ai evidenton dobësitë dhe boshllëqet në mënyrën e aplikimit të këtij modeli. Gjithashtu, ofron rekomandime që nuk janë deklarata në nivel aspiratash, por masa konkrete dhe të zbatueshme, duke u mbështetur në praktikat më të mira nga vende të tjera, duke adresuar sfidat ekzistuese dhe përmirësuar efektivitetin e modelit.

Më shumë se një në çdo njëzet persona në Shqipëri, rreth 140,000 individë, janë persona me aftësi të kufizuara, dhe ky numër vazhdon të rritet për shkak të rritjes së jetëgjatësisë dhe avancimeve në trajtimet mjekësore dhe teknologji. Më shumë se 11.8 milion euro, janë alokuar nga qeveria në mbështetje të nevojave të personave me aftësitë kufizuara. Megjithatë, vetëm 3.2% e fondeve të alokuara për periudhën 2019–2024 mund të gjurmohen bazuar në të dhënat e publikuara aktualisht nga qeveria. Edhe pse shpenzimet lidhur me aftësinë e kufizuar janë rritur me 24% midis viteve 2019 dhe 2024, numri i përfituesve ka pësuar një ulje me 2,684 individë që kanë marrë pagesa, duke ngritur shqetësime mbi efektivitetin e masave qeveritare dhe mjeteve të përdorura për zbatimin e buxhetit. Këto shqetësime thellohen edhe më shumë nga mungesa e treguesve të performancës për reformën, gjë që vë në diskutim mekanizmat që qeveria përdor për të matur progresin dhe për të adresuar boshllëqet në vitet në vijim.

Ky dokument, i zhvilluar me kontributin e një sërë aktorësh kyç, përfshirë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Inspektoratin e Punës, njësitë e qeverisjes lokale, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe organizatat joqeveritare që veprojnë në sektorin e aftësisë së kufizuar, dhe i përpunuar gjatë disa muajve, synon të mbështesë ekspertët e politikave, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, organizatat joqeveritare, etj., në identifikimin e boshllëqeve dhe adresimin e tyre përmes një strategjie gjithëpërfshirëse. Ai gjithashtu do të ndihmojë dikasteret qeveritare në kontribuimin për ndryshime praktike dhe të qëndrueshme, që mund të bëjnë një diferencë të prekshme në jetën e personave me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin, duke nxjerrë një plan konkret veprimi me tregues të suksesshëm të qartë dhe të detajuar.

Ky dokument i bën thirrje qeverisë që të njohë dhe vlerësojë kontributet e personave me aftësi të kufizuar, si dhe të dëgjojë dhe të përgjigjet ndaj nevojave të tyre. Gjithashtu, është një thirrje për veprim në të gjithë shoqërinë, pasi çështjet e aftësisë së kufizuar prekin të gjithë.



Ky vlerësim është i përbërë nga dy pjesë:

## Pjesa 1

Shqyrton situatën aktuale në Shqipëri, duke përfshirë kuadrin ligjor dhe ekonomik në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Ajo plotësohet nga të dhëna parësore të mbledhura përmes intervistave me aktorët kyç, të cilat përbëjnë rekomandimet dhe ndryshimet e mundshme në kuadrin ligjor ekzistues, strategjik dhe operacional.

## Pjesa 2

Identifikon boshllëqet dhe sfidat në buxhetin e lidhur me personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2019–2024, duke marrë parasysh Planin Kombëtar të Veprimit 2021–2025, si dhe raporte të ndryshme monitorimi mbi zbatimin e buxhetit. Ajo paraqet të dhëna financiare që synojnë të informojnë për rregullimet e buxhetit vjetor të ardhshëm, veçanërisht në lidhje me shpenzimet në sektorin e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, ofron rekomandime për përmirësimin e disponueshmërisë së të dhënave, në mënyrë që të mundësohet një monitorim më efektiv i zbatimit të buxhetit.

# Gjetjet kryesore sipas tematikave

## QEVERISJE

**Gjetje 1:** Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara (Këshilli) është karakterizuar nga funksionim jo i rregullt, ndikim i kufizuar në vendimmarrje, mungesë transparence dhe përfaqësim jo i mjaftueshëm gjithëpërfshirës. Rekomandimet e aktorëve kyç shpesh mbeten formalitete procedurale dhe nuk pasohen nga veprime ose mekanizma zbatimi nga institucionet përgjegjëse, veçanërisht në lidhje me vlerësimin bio-psiko-social.

**Gjetja 2:** Mungon transparenca lidhur me përfitimet dhe sfidat e projektit pilot të zbatuar në tre qarqe që nisi në vitin 2017<sup>1</sup> për prezantimin e skemës së re bio-psiko-sociale, si dhe mënyrën se si këto sfida u adresuan kur skema u zgjerua në nivel kombëtar. Gjithashtu, mungon qartësia dhe nuk ka dëshmi të disponueshme që të tregojnë se është kryer një vlerësim i kapaciteteve, burimeve njerëzore, aksesueshmërisë, përfshirë banesat dhe vendet e tjera të kujdesit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe i nevojave të përgjithshme para kalimit nga modeli i vjetër mjekësor tek skema e re bio-psiko-sociale.

**Gjetja 3:** Të dhënat e siguruar nga shumica e aktorëve kyç tregojnë se kapacitetet dhe shërbimet e ofruara për personat me aftësi të kufizuara janë shpesh më të ulëta se ato të rekomanduara nga Komisioni Shumëdisiplinor. Evidentohet mungesë harmonizimi dhe kohezioni ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre vendore, veçanërisht në drejtim të aftësive dhe kohës së burimeve njerëzore, si dhe të infrastrukturës, e cila nuk përputhet me nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Kjo situatë ngre shqetësime lidhur me efektivitetin praktik të zbatimit të qasjes bio-psiko-sociale. Një nga shqetësimet kryesore të ngritura nga aktorët kyç është mungesa e theksuar e qendrave të shëndetit mendor, të cilat mbeten në masë të madhe të papranishme në shumë qytete dhe zona të vendit.

**Gjetja 4:** Evidentohet një qasje e fragmentuar dhe e izoluar brenda Komisionit Shumëdisiplinor gjatë vlerësimit të nevojave të aplikantëve në lidhje me aftësinë e kufizuar. Kontributet nga mjekët e familjes, mjekët specialistë, qendrat shëndetësore që ofrojnë shërbime, si dhe zyrat e punësimit, shpesh mungojnë, duke çuar në vendimmarrje që mund të jenë të pasakta dhe jo konsistente edhe për aplikantë me kushte të ngjashme të aftësisë së kufizuar. Mungesa e mjeteve të automatizuara e vështirëson më tej mundësinë e palëve përkatëse për të ofruar dhe ruajtur informacionin në një sistem të centralizuar. Kjo kufizon mundësinë e Komisionit Shumëdisiplinor për t'i bazuar vendimet në historikun e plotë të aplikantit dhe për të përdorur të dhënat e mbledhura për hartimin e raporteve të sakta mbi progresin e aplikantëve, si dhe për identifikimin e nevojave në nivel kombëtar në lidhje me kapacitetet, shërbimet dhe infrastrukturën.

## STRATEGJIKE

[1] Skema bio-psiko-sociale në Shqipëri u pilotua fillimisht në Bashkinë e Tiranës (Njësitë Administrative nr. 6 dhe 7), e ndjekur më pas nga bashkitë e Durrësit dhe Elbasanit.

**Gjetje 5:** Administratorët Socialë luajnë një rol thelbësor në zbatimin e qasjes bio-psiko-sociale dhe në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Megjithatë, efektiviteti i tyre kufizohet nga mungesa e burimeve, trajnimet e pamjaftueshme, si dhe mungesa e automatizimit dhe e dokumentacionit të standardizuar. Këto boshllëqe e bëjnë punën e tyre joefikase, duke i detyruar të përqendrohen më shumë në detyra burokratike sesa në mbështetjen direkte të personave me aftësi të kufizuara, përmes informimit të tyre mbi të drejtat dhe përfitimet që u takojnë sipas legjislacionit në fuqi.

**Gjetje 6:** Megjithëse i parashikuar në kuadrin ligjor që prej vitit 2023, Fondi Social i Punësimit, i cili synon promovimin e punësimit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, ende nuk është aktivizuar apo zbatuar në praktikë.

**Gjetje 7:** Ekziston perceptimi ndërmjet grupeve të interesit se diagnozat mjekësore vijnë të përcaktojnë klasifikimin e aftësisë së kufizuara. Kjo situatë vazhdon pavarësisht qëllimit të modelit të ri, i cili promovon një qasje holistike ndaj shëndetit dhe sëmundjes, duke marrë në konsideratë jo vetëm faktorët biologjikë, por edhe aspektet psikologjike, si mendimi dhe sjellja.

**Gjetje 8:** Evidentohen të dhëna kontradiktore të ofruara nga institucione të ndryshme shtetërore, si Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Inspektorati Shtetëror i Punës, duke krijuar paqartësi lidhur me situatën reale të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Për më tepër, nuk ishte e mundur të siguroheshin të dhëna primare mbi progresin e punësimit apo mbi strategjitë e ardhshme për përmirësimin e rezultateve në punësim për personat me aftësi të kufizuara, për shkak të kapaciteteve të kufizuara të stafit të AKPA-s për të marrë pjesë në intervistat e zhvilluara.

**Gjetje 9:** Ekziston paqartësi ndërmjet akteve të ndryshme ligjore, e cila në praktikë çon në konfuzion lidhur me detyrimin për paraqitjen fizike të aplikantit përpara Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar. Në rastet e aftësisë së kufizuar të rëndë, ky detyrim krijon vështirësi të konsiderueshme logjistike dhe kosto shtesë, veçanërisht për personat që jetojnë në zona rurale me mundësi të kufizuara transporti. Për më tepër, nuk është parashikuar asnjë fond buxhetor për mbulimin e shpenzimeve të anëtarëve të Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar për të zhvilluar vizita në vendbanimin e aplikantëve, kur këto vizita janë të nevojshme.

**Gjetje 10:** Njoftimi i Vendimit të nxjerrë nga Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë së Kufizuar nuk përmban të gjithë elementët thelbësorë që kërkohen për një akt administrativ. Për më tepër, formati i miratuar dhe aktualisht në përdorim paraqet mungesë qartësie.



**Gjetje 11:** Megjithëse fondet e shpenzuara për personat me aftësi të kufizuara (PAK) dhe kujdestarët e tyre nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale janë rritur nga 15.86 miliardë lekë në vitin 2019 në 19.6 miliardë lekë në vitin 2024, numri i përfituesve ka shënuar rënie (me rreth 2,864 individë), duke ngritur pikëpyetje mbi efikasitetin e përdorimit të këtyre fondeve publike. Pagesat direkte për PAK variojnë nga 10% deri në 21% të pagës mesatare dhe rezultojnë dukshëm më të ulëta krahasuar me vende me profil të ngjashëm në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, konstatohet mungesë e treguesve të qartë të performancës, si dhe mungesë udhëzimesh të detajuara dhe një zbatim i fragmentuar i fondeve sociale në nivel të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.

**Gjetje 12:** Pavarësisht legjislacionit që detyron punëdhënësit të punësojnë PAK dhe ekzistencës së Fondit Social të Punësimit, zbatimi i politikave ka qenë minimal dhe joefektiv. Numri i PAK të papunë të regjistruar është ulur ndjeshëm nga 542 në 2019 në 237 në 2022. Numri i PAK të punësuar ka rënë në mënyrë drastike nga 82 në 2019 në vetëm 18 në 2022. Fondet e buxhetit të shtetit për programet e nxitjes së punësimit për PAK përbëjnë vetëm 1% të shpenzimeve totale, një trend konstant. Zbatimi i politikës së ndërmarrjeve sociale ka nisur me vonesë dhe me rezultate minimale.

**Gjetje 13:** Numri i mësuesve ndihmës është rritur ndjeshëm nga 620 në 2019 në 2,167 në 2024, me shpenzime të vlerësuara prej 2.34 miliardë lekë në 2024. Ka të dhëna kontradiktore dhe një rënie të ndjeshme të numrit të nxënësve në qendrat burimore (nga 700 në 2019 në 160 në 2024), ndërkohë që shpenzimet për ta janë rritur. Mungon analiza e performancës së këtyre qendrave. Të dhënat nga Ministria e Arsimit janë të pjesshme, të paqarta dhe kontradiktore, veçanërisht për bursa apo tekste shkollore falas dhe investimet në aksesueshmërinë shkollore.

**Gjetje 14:** Aksesueshmëria është një objektiv i rëndësishëm i PKPAK (19% e kostos totale), por zbatimi është i pjesshëm dhe i fragmentuar. Mungon transparenca dhe llogaridhënia nga ana e ministrisë përgjegjëse për transportin lidhur me zbatimin e këtij objekti. Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit konkludon se kuadri ligjor nuk po implementohet si duhet. Bashkitë nuk kanë plane specifike apo monitorim sistematik dhe legjislacioni nuk është i harmonizuar me standardet e BE-së. Për sa i përket aksesueshmërisë në informacion (p.sh., platforma e-Albania), masat janë planifikuar për vitin 2026 dhe deri tani nuk është realizuar asnjë masë konkrete.

## Përmbledhje e rekomandimeve:

**Rekomandim i Përgjithshëm:** Qeveria Shqiptare duhet të hartojë një Strategji Kombëtare Afatgjatë për Aftësinë e Kufizuar 2026–2030 (Strategjia), e cila të përcaktojë masa konkrete për përmirësimin e jetës së përditshme të të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Kjo duhet të përfshijë angazhime të menjëhershme për rritjen e cilësisë së jetës së tyre, garantimin e përfshirjes në proceset e hartimit të politikave dhe ofrimit të shërbimeve, si dhe përcaktimin e veprimeve specifike që çdo institucion përgjegjës duhet të ndërmarrë për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë.

01

Strategjia duhet të artikulojë një vision qeveritar afatgjatë për të transformuar përvojën e jetuar të personave me aftësi të kufizuara, duke adresuar shtylla themelore si pabarazitë në arsim, punësim, strehim, transport, shërbime publike dhe ndër të tjera jetën qytetare.

02

Strategjia duhet të ndërtohet mbi bazën e shqetësimeve dhe perceptimeve të vetë personave me aftësi të kufizuara, duke pasur një shtrirje shumë më të gjerë se Strategjia Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar 2021–2025. Duhet të ndërmerret një proces i mirëfilltë dhe gjithëpërfshirës konsultimi, i cili të mos kufizohet vetëm në kontributet e një ose dy organizatave të shoqërisë civile, në mënyrë që Strategjia të përcaktojë masa konkrete që përmirësojnë realisht të gjitha aspektet e jetës së personave me aftësi të kufizuara

03

Për të shmangur mbetjen në nivel aspiratash, Strategjia duhet të përfshijë një plan të plotë dhe afatgjatë zbatimi, me rezultate të matshme, mekanizma të fortë monitorimi dhe vlerësimi, përfshirje reale të personave me aftësi të kufizuar, financim të mjaftueshëm dhe koordinim të fuqishëm ndërinstitucional.

04

Strategjia duhet të përfshijë gjithashtu një fushatë ndërgjegjësimiti që promovon informimin dhe kuptimin se çështjet e aftësisë së kufizuar janë përgjegjësi e gjithë shoqërisë dhe që inkurajon ndryshime pozitive në sjelljen individuale. Ajo duhet gjithashtu të përcaktojë mënyrën se si qeveria do të bashkëpunojë me aktorë të ndryshëm të shoqërisë për të nxitur ndryshime transformuese afatgjata, përfshirë partneritete me sektorin e biznesit.

05

Të vendoset një proces i qartë për monitorimin dhe raportimin vjetor të arritjeve të Strategjisë Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar, duke përdorur rezultatet, produktet dhe treguesit e përcaktuar në Strategji. Të sigurohet publikimi i rregullt i raporteve të monitorimit për të promovuar transparencën dhe për t'u mundësuar organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të kontribuojnë në zbatimin efektiv të saj përmes vlerësimit të progresit të Strategjisë.

# Rekomandime

## Rekomandimi 1:

Të forcohet mbikëqyrja institucionale duke siguruar funksionimin efektiv të Këshillit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ky këshill duhet të mbledhet të paktën dy herë në vit, të përfshijë një përfaqësim të larmishëm dhe aktiv nga shoqëria civile dhe nga vetë personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndjekë një plan të qartë vjetor pune. Nevojiten mekanizma transparentë për ndjekjen, zbatimin dhe raportimin publik të rekomandimeve, të mbështetur nga publikimi i procesverbaleve dhe raporteve të monitorimit. Vlerësimet periodike të ndikimit të Këshillit do të ndihmonin në forcimin e vendimmarrjes së bazuar në evidencë dhe në përmirësimin e politikave për personat me aftësi të kufizuara.

## Rekomandimi 2:

Të rritet transparenca dhe llogaridhënia publike përmes përcaktimit të rezultateve dhe treguesve të qartë, si dhe përmes publikimit të rregullt të raporteve të monitorimit dhe vlerësimit mbi reformën, duke përfshirë progresin në arritjen e rezultateve kryesore, sfidat dhe ankesat. Të krijohen mekanizma dhe mjete që u mundësojnë organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë përkatës të marrin pjesë në mënyrë të plotë në proceset e mbikëqyrjes dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.



## Rekomandimi 3:

- Të forcohen bazat analitike të modelit bio-psiko-social përmes realizimit të një analize gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar mbi kontekstin dhe kapacitetet sociale, ekonomike dhe territoriale të Shqipërisë. Në procesin e vlerësimit të integrohen tregues të përshtatur me realitetin vendas, si niveli i varfërisë, aksesin në shërbime, barrierat mjedisore që lidhen me stilin e jetesës, si dhe mbështetja familjare, në mënyrë që të sigurohet një kuptim holistik i kësaj qasjeje.
- Të kryhet një hartëzëm gjithëpërfshirës i kapaciteteve, përfshirë infrastrukturën dhe burimet, në të gjithë vendin. Komisioni Shumëdisiplinor duhet të përcaktojë alternativa të përshtatshme, si shërbime alternative në natyrë ose kompensim financiar, në rastet kur institucionet publike ose ofruesit e shërbimeve shëndetësore nuk kanë kapacitetin për të ofruar shërbimet e kërkuara.

## Rekomandimi 4.1:

Të forcohet bashkëpunimi ndër-institucional përmes formalizimit të koordinimit dhe kontributit të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara, përfshirë mjekët e përgjithshëm (mjekët e familjes), klinikat e specializuara, ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbime të tjera mjekësore që ofrojnë mbështetje në natyrë, si dhe administratorët socialë që ndjekin nga afër progresin e personave me aftësi të kufizuara.

## Rekomandimi 4.2:

Të krijohet një sistem i integruar dhe i automatizuar që u mundëson të gjitha palëve përkatëse, profesionistëve të shëndetësisë, administratorëve socialë, shërbimeve specialistike dhe komisioneve shumë-disiplinore të vlerësimit, të regjistrojnë drejtpërdrejt informacionin në një platformë të unifikuar.

## Rekomandimi 5.1:

Të alokohet staf shtesë, mjete pune dhe transport i dedikuar ose njësi vlerësimi të lëvizshme për të lehtësuar zhvillimin e vizitave në banesë nga administratorët socialë të paktën një herë në tremujor, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 722.

## Rekomandimi 5.2:

Të zhvillohet dhe të zbatohet një program i strukturuar dhe i vazhdueshëm për zhvillimin profesional të administratorëve socialë, duke përfshirë trajnime mbi përfitimet dhe sfidat e qasjes bio-psiko-sociale. Trajnimet duhet të përfshijnë të nxënit praktik të bazuar në raste konkrete, si dhe udhëzime praktike për komunikim etik, respektues dhe empatik me personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre.



## Rekomandimi 5.3:

Të hartohet dhe të shpërndalet një manual gjithëpërfshirës ose një sërë procedurash standarde operative për administratorët socialë, i cili të përcaktojë qartë të gjitha fazat e procesit të vlerësimit, pritshmëritë për vizitat në banesë dhe kërkesat e detajuara të raportimit për personat me aftësi të kufizuara. Ky manual duhet të përmbajë udhëzime hap pas hapi, shembuj praktikë, standarde të komunikimit etik, si dhe udhëzime për përgatitjen e vizitave në banesë, angazhimin respektues me personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, si dhe dokumentimin e vëzhgimeve në mënyrë të strukturuar dhe objektive. Gjithashtu, të zhvillohen forma dhe formate të standardizuara për regjistrimin e feedback-ut nga vizitat në banesë të personave me aftësi të kufizuara, për të promovuar uniformitetin dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore.

## Rekomandimi 5.4:

Të krijohet një sistem elektronik për ndjekjen e të dhënave të vlerësimit, duke reduktuar rrezikun e dokumentacionit të paplotë ose jo të qëndrueshëm dhe duke siguruar integrim të plotë me Regjistrin Elektronik Kombëtar. Ky sistem duhet të funksionojë si një platformë qendrore dhe e sigurt, ku administratorët socialë mund të regjistrojnë informacion në kohë reale. Në një fazë më të avancuar, analiza e integruar mund të ndihmojë në identifikimin e trendeve, të evidentojë rastet komplekse për rishikim të mëtejshëm shumëdisiplinor dhe të mbështesë planifikimin afatgjatë në nivel politikash.

## Rekomandimi 6:

Të zbatohet dhe të bëhet efektiv Fondi Social i Punësimit për të mbështetur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, duke financuar masa të lidhura me punësimin, si trajnime profesionale, përshtatje të vendit të punës dhe zhvillim të aftësive. Fondi mund të mbështesë iniciativa si job-coaching, skema të punësimit të mbështetur, grante për sipërmarrësi për personat me aftësi të kufizuara, dhe stimuj për punëdhënësit që demonstrojnë praktika përfshirëse të punësimit.

## Rekomandimi 7:

Të promovohen ndryshime të qarta nga një qasje e bazuar vetëm mbi diagnozat drejt një kuptimi holistik, bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, përmes investimit në ndërgjegjësim, trajnime dhe praktika të qëndrueshme në të gjitha nivelet e sistemit të vlerësimit. Kjo duhet të përfshijë fushata komunikimi të synuara për profesionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe mbikëqyrësit, për të shpjeguar se klasifikimi i aftësisë së kufizuar nuk përcaktohet më vetëm nga diagnozat mjekësore, por nga mënyra se si gjendet shëndetësore ndërveprojnë me faktorët psikologjikë, sjelljen dhe barrierat sociale. Programet trajnuese për vlerësuesit, personelin mjekësor, administratorët socialë dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces duhet të theksojnë vlerësimin funksional, përvojën e jetuar dhe faktorët kontekstualë, duke ndihmuar aktorët kyç dhe praktikuesit të largohen nga një qasje e ngushtë klinike. Mjetet e standardizuara, shembujt e rasteve dhe udhëzimet për vendimmarrje mund të forcojnë këtë ndryshim në praktikën e përditshme.

## Rekomandimi 8.1:

Të mblidhen dhe të publikohen të dhëna të sakta mbi aftësinë e kufizuar. Në detaje, statistikave duhet të përfshijnë: numrin e personave me aftësi të kufizuara të punësuar, normën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, hendekun në punësim për grupmoshën 16–65 vjeç, numrin e personave me aftësi të kufizuara krahasuar me popullsinë në moshë pune, ndryshimet në hendekun e punësimit sipas moshës, dhe normën e punësimit të grave me aftësi të kufizuara krahasuar me normën e burrave me aftësi të kufizuar.



## Rekomandimi 8.2:

Të përgatitet një plan veprimi brenda strategjisë së re kombëtare për mënyrën se si sektori i punës të bëhet më përfshirës dhe i aksesueshëm, duke paraqitur propozime që lejojnë personat me aftësi të kufizuara jo vetëm të fillojnë, por edhe të qëndrojnë në punë; të inkurajohen punëdhënësit të punësojnë, të mbajnë dhe të zhvillojnë punonjësit e tyre me aftësi të kufizuara dhe të krijojnë vende pune përfshirëse me përshtatje të arsyeshme; të forcohen të drejtat në vendin e punës përmes punës fleksibile dhe përmirësimit të aksesit në këshilla mbi të drejtat e punësimit për personat me aftësi të kufizuara dhe punëdhënësit; të eksplorohej me personat me aftësi të kufizuara se çfarë ndihme shtesë do të ishte më e dobishme për ata që dëshirojnë të fillojnë një biznes; të promovohen mundësitë për personat me aftësi të kufizuara në Shërbimin Civil dhe të sigurohet mbështetje për t'u integruar në punë.

## Rekomandimi 9.1:

Të bëhen ndryshimet e nevojshme në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e shumës, kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe dhënien e statusit të aftësisë së kufizuar dhe Asistentit Personal, si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre,” për t'u mundësuar aplikantëve-persona me aftësi të kufizuara të intervistohen në vendbanimin e tyre kur gjendja shëndetësore, kufizimet e lëvizshmërisë ose rrethanat personale e bëjnë të vështirë ose të pamundur pjesëmarrjen fizike në vlerësime. Ky ndryshim duhet të përcaktojë qartë kriteret e pranueshmërisë për intervistat në banesë, të përshkruajë përgjegjësitë e Komisioneve Shumëdisiplinore dhe të vendosë masa procedurale për të siguruar që vlerësimet në banesë të kryhen me të njëjtin rigorozitet dhe dinjitet si ato të zhvilluara në ambientet e Shërbimeve Sociale.

## Rekomandimi 10:

Të bëhen ndryshime në Formularin e Njoftimit të Vendimit të nxjerrë nga Komisionet Shumëdisiplinore, në mënyrë që të përcaktojë qartë të drejtën e aplikantit për të apeluar, bazën ligjore të vendimit dhe autoritetin kompetent ose gjykatën përgjegjëse për shqyrtimin e ankesës. Formulari duhet të specifikojë afatin për dorëzimin e ankesës, organin administrativ që duhet ta shqyrtojë fillimisht, dhe autoritetin gjyqësor që ka juridiksion nëse aplikanti kërkon një rishikim të mëtejshëm.

## Rekomandimi 11.1:

Rekomandohet rritja progresive dhe e qëndrueshme e financimit për personat me aftësi të kufizuara nga buxheti i shtetit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe garantimin e ushtrimit të plotë të të drejtave themelore. Rritja e financimit duhet të përqendrohet jo vetëm në pagesat direkte, por edhe në zgjerimin dhe forcimin e shërbimeve sociale komunitare, mbështetjen për jetesë të pavarur, si dhe në ofrimin e shërbimeve të integruara sociale dhe shëndetësore. Në këtë kuadër, planifikimi buxhetor duhet të bazohet në nevoja reale, analiza të kostos së shërbimeve dhe monitorim të vazhdueshëm të ndikimit të shpenzimeve publike.

## Rekomandimi 11.2:

Të vendosen standarde të qarta dhe të detyrueshme për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave të disagreguara (sipas kategorive të aftësisë, gjeografisë, moshës dhe gjinisë) nga të gjitha ministrat dhe institucionet përgjegjëse. Monitorimi duhet të fokusohet te treguesit e performancës dhe rezultatet konkrete të arritura, jo vetëm te shpenzimet e fondeve.

## Rekomandimi 11.3:

Të krijohen mekanizma më të fortë koordinimi ndërmjet ministrave dhe njësive të qeverisjes vendore për të siguruar një qasje holistike dhe të integruar në ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e politikave për personat me aftësi të kufizuara (PAK).

## Rekomandimi 12:


Të garantohet ngritja dhe funksionimi i duhur i fondeve sociale në çdo bashki, me udhëzime të qarta dhe kapacitete të forta administrative. Të analizohen shkaqet e dështimit të politikave të punësimit për PAK dhe të zhvillohen programe më të targetuara, me financim të duhur dhe mekanizma të fortë monitorimi.

## Rekomandimi 13:

Të zgjidhen mospërputhjet në të dhënat për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe të sigurohet një sistem i qëndrueshëm dhe transparent për monitorimin e tyre. Të investohet në infrastrukturën shkollore për të garantuar aksesueshmërinë dhe në burime të dedikuara për zhvillimin e mësuesve ndihmës dhe specialistëve të tjerë.

## Rekomandimi 14:

Të hartohen dhe zbatohen plane specifike dhe afate të qarta për aksesueshmërinë fizike në infrastrukturën publike dhe transportin rrugor, duke siguruar harmonizimin me standardet e BE-së. Të përshpejtohet implementimi i aksesueshmërisë digjitale për platformat e-Albania dhe faqet e internetit të institucioneve publike, duke garantuar që këto masa të jenë operative shumë më herët se viti 2026.




# Hyrje



## KONTEKSTI

**Modeli bio-psiko-social** është një kuadër holistik për kuptimin dhe vlerësimin e aftësisë së kufizuar, i cili integron dimensionet biologjike, psikologjike dhe sociale të funksionimit. Kjo qasje konceptualizon aftësinë e kufizuar si rezultat i ndërveprimeve midis gjendjes shëndetësore të individit dhe faktorëve kontekstualë, përfshirë barrierat mjedisore, qëndrimet sociale dhe faktorët personalë.<sup>2</sup> Ndërsa ky model ofron një kuadër të fokusuar te personi dhe lehtëson koordinimin ndërsektorial të politikave midis sistemeve të shëndetësisë, mbrojtjes sociale, arsimit dhe punësimit, ai gjithashtu paraqet sfida. Natyra e tij multidimensionale e bën procesin e vlerësimit kompleks, kërkon shumë burime dhe të vështirësohet standardizimi. Subjektiviteti në vlerësimin e faktorëve psikosocialë dhe mjedisorë ndikon në qëndrueshmërinë dhe krahasueshmërinë e vlerësimeve. Për më tepër, zbatimi në mjedise me kapacitete të kufizuara mund të pengohet nga sistemet e të dhënave të limituara, mungesa e ekspertizës profesionale dhe mekanizmat e koordinimit ndërinstucional.

### Modeli biopsikosocial i shëndetit



*Burimi: Cumbria.nhs.uk*

[2] World Health Organization (2001) – International Classification of Functioning, Disability and Health (ICF)



Dokumenti i Politikave “Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale dhe Plani i Veprimit 2019–2024” ka paraprirë futjen e reformës bio-psiko-sociale në Shqipëri. Arsyetimi për reformimin e skemave të vlerësimit dhe mbështetjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri bazohej në:

1

Njohjen e kufizimeve të vlerësimit vetëm mjekësor: Para reformës, aftësia e kufizuar përcaktohej kryesisht mbi bazën e dëmtimeve mjekësore, gjë që shpesh nuk pasqyronte kufizimet funksionale dhe barrierat për pjesëmarrje sociale që ndikojnë në cilësinë e jetës dhe përfshirjen e individëve.

2

Përputhshmëria me standardet e të drejtave të njeriut: Kalimi drejt vlerësimit holistik pasqyron detyrimet e Shqipërisë sipas Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK), duke bazuar njohjen dhe mbështetjen e aftësisë së kufizuar mbi të drejtat e barabarta, dinjitetin dhe pjesëmarrjen e plotë, jo vetëm mbi ashpërsinë e dëmtimit.

3

Lidhja me mbrojtjen sociale dhe përfshirjen në tregun e punës: Vlerësimi i përmirësuar lidhej gjithashtu me qëllime më të gjera politike, si aktivizimi në tregun e punës, planifikimi individual i mbështetjes dhe mbyllja e boshllëqeve në mbulimin e mbrojtjes sociale për personat me aftësi të kufizuara.

Sipas Qeverisë, reforma përfaqëson një ndryshim struktural drejt një sistemi më të drejtë, të koordinuar dhe të qëndrueshëm të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i përputhur me parimet e mbrojtjes sociale gjithëpërfshirëse.

Modeli bio-psiko-social u prezantua formalisht përmes Ligjit nr. 57/2019 “Për Ndihmën Sociale dhe Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar në Shqipëri” (i ndryshuar), duke përcaktuar aftësinë e kufizuar si një funksion i faktorëve të ndërvarur biologjikë, psikologjikë dhe socialë, që ndikojnë në funksionimin e përditshëm dhe pjesëmarrjen shoqërore, në përputhje me kuadrin ndërkombëtar si Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke reflektuar një qasje holistike dhe të bazuar mbi të drejtat.



Zbatimi i modelit në Shqipëri u realizua përmes njësive të qeverisjes vendore, me role kyçe për Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të cilat kryenin vlerësime dhe lëshonin vendime, Bashkitë që menaxhonin procedurat financiare, dhe Këshilli i Ministrave që përcaktonte kriteret, procedurat dhe përgjegjësitë. Të dhënat menaxhohen përmes Regjistrat Elektronik Kombëtar për të siguruar standardizim dhe koordinim.

Sipas raportimeve mediatike, reforma ka shkaktuar pakënaqësi te personat me aftësi të kufizuara, me qindra individë që raportuan përjashtimin nga programi i mbështetjes ose ndryshime në kategorizimin e tyre.<sup>3</sup>

Raportohej për:

1. Riklasifikim të rasteve, veçanërisht te personat me aftësi të kufizuara të pjesshme ose të moderuar;
2. Disa individë që më parë ishin të përfshirë nën modelin mjekësor u shpallën të papërfshirë ose u caktuan nivele më të ulëta mbështetjeje sipas kriterëve funksionale;
3. Vonesa në rivlerësim krijoi pezullim të përkohshëm të përfitimeve për disa aplikantë.

Pas zbatimit të modelit bio-psiko-social, u vërejt një ulje e prevalencës së raportuar të aftësisë së kufizuar. Megjithatë, nuk u gjetën prova për një heqje masive kombëtare të statusit të aftësisë së kufizuar në vitin 2019, pavarësisht perceptimit të krijuar. Reforma nuk u projektua zyrtarisht si një masë për kursim të kostove ose heqje masive, por si një ndryshim struktural nga modeli mjekësor drejt një modeli të bazuar mbi funksionalitetin.

Të dhënat administrative kombëtare tregojnë se, sipas statistikave zyrtare të mbrojtjes sociale, në vitet 2018–2019 rreth 140,000–168,000 persona ishin të njohur në skemat zyrtare të aftësisë së kufizuar, që korrespondon me rreth 4.8 %–5.9 % të popullsisë, duke përfutur benefite ose shërbime të lidhura me aftësinë e kufizuar përmes programeve të ndryshme.<sup>4</sup> Në fund të vitit 2019, statistikave zyrtare nga Shërbimi Social Shtetëror i Shqipërisë identifikuan rreth 147,199 persona si të njohur zyrtarisht me aftësi të kufizuara, ose rreth 5.2 % e popullsisë kombëtare. Nga këta, 75,016 persona u kategorizuan si “invalidë pune”, përfitues të sigurimeve shoqërore dhe pagesave të mbrojtjes sociale, ndërsa 72,183 persona merrnin shërbime dhe përfitime të lidhura me aftësinë e kufizuar në kuadër të sistemit të mbrojtjes sociale.

[3] <https://www.syri.net/kronike/583456/investigimi-skema-e-re-e-aftesise-se-kufizuar-demon-qindra-te-semure/>  
<https://shendeti.com.al/reforma-e-aftesise-se-kufizuar-sfidat-e-perfituesve/>

[4] Unicef (2021), Analiza e Situates se Femijve dhe adoleshenteve ne Shqiperi



Që nga miratimi i modelit bio-psiko-social në vitin 2019, ka pasur një rritje të konsiderueshme në numrin e Personave me Aftësi të Kufizuara të vlerësuar, e cila vazhdoi deri në vitin 2025. Grafiku i trendit ilustron ndryshimet në numrin e Personave me Aftësi të Kufizuar të vlerësuar gjatë periudhës 2019–2025. Siç shihet, rritja më e lartë u regjistrua pas zbatimit kombëtar të modelit bio-psiko-social në vitin 2022, duke reflektuar zgjerimin e mbulimit të vlerësimeve dhe rritjen e kërkesës për shërbime të lidhura me aftësinë e kufizuar<sup>5</sup>.



Reforma bio-psiko-sociale e vitit 2019 në Shqipëri përfaqësonte një modernizim struktural të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i përputhur me standardet ndërkombëtare megjithatë, sfidat gjatë zbatimit tranzitor krijuan shqetësim tek përfituesit, veçanërisht lidhur me humbjen ose uljen e mundshme të përfitimeve. Pa një zgjerim paralel të shërbimeve komunitare dhe mbështetjes psiko-sociale, disa përfitues e perceptuan reformën më shumë si kufizuese sesa fuqizuese.<sup>6</sup>

Pavarësisht se reforma ishte një ndryshim i rëndësishëm politik, vihet re një mungesë e konsiderueshme e raporteve publike të monitorimit dhe e publikimeve të studimeve pilot të rishikuara nga kolegët që të vlerësojnë performancën e reformës në praktikë. Burimet e shoqërisë civile dhe dokumentet politike kanë vënë në dukje mungesën e raporteve të monitorimit të reformës të aksesueshme për të ndjekur arritjet ose sfidat, duke lënë palët e interesuara dhe komunitetet e prekura pa prova të qarta mbi progresin. Kjo është theksuar gjithashtu nga raportet e mëparshme mbi këtë çështje.<sup>7</sup>

[5] Musa, Rama, Fino (2026), transforming disability assessment in Albania: progress and challenges of the biopsychosocial model [https://www.researchgate.net/publication/400123635\\_Transforming\\_disability\\_assessment\\_in\\_Albania\\_progress\\_and\\_challenges\\_of\\_the\\_biopsychosocial\\_model](https://www.researchgate.net/publication/400123635_Transforming_disability_assessment_in_Albania_progress_and_challenges_of_the_biopsychosocial_model)

[6] Shoqata e Diabetit ne Shqiperi (2021), Raport monitorimi i shoqërisë civile për sistemin e ri të vlerësimit për aftësinë e kufizuar <https://www.diabeti-albania.org/raport-monitorimi-i-shoqerise-civile-per-sistemin-e-ri-te-vleresimit-per-afesine-e-kufizuar/>

[7] IDM (2022), Improving the situation of personal assistants and the progress of the reform for the bio-psycho-social assessment of persons with disabilities [https://idmalbania.org/wp-content/uploads/dlm\\_uploads/2022/09/Mbi-situaten-e-ndihmesit-personal-dhe-vleresimi-psiko-social.pdf](https://idmalbania.org/wp-content/uploads/dlm_uploads/2022/09/Mbi-situaten-e-ndihmesit-personal-dhe-vleresimi-psiko-social.pdf)

## 3. Objektivat dhe fusha e punës



Qëllimi i këtij vlerësimi është të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse të skemës së re të aftësisë së kufizuar, bazuar në modelin bio-psiko-social të zbatuar në Shqipëri, dhe implikimet e saj për personat me aftësi të kufizuara dhe shoqërinë në përgjithësi. Përfundimet e kësaj analize do të shërbejnë si bazë për një fushatë advokimi e fokusuar në rishikimin dhe përmirësimin e programeve dhe politikave ekzistuese, optimizimin e alokimit të burimeve për mbështetjen e nevojave të personave me aftësi të kufizuara, si dhe promovimin e përdorimit më efikas të fondeve publike.

Ky vlerësim shqyrton në mënyrë sistematike dhe objektive: a) kriteret e vlerësimit të skemës së re të aftësisë së kufizuar, b) mekanizmat ligjorë mbështetës, c) përfitimet dhe financimin e alokuar për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ofron rekomandime të zbatueshme për të përmirësuar performancën e përgjithshme të skemës.

Audienca kryesore e këtij raporti përfshin individët e prekur nga skema, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në sektorin e aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të njeriut, organet qendrore dhe vendore të qeverisjes, institucionet e përfshira në zbatimin e modelit bio-psiko-social, si dhe familjet e personave me aftësi të kufizuar, shkollat dhe qendrat arsimore. Vlerësimi është kryer nga tetori 2025 deri në mars 2026.



## 4. Metodologjia



### Përmbledhje:

Mbledhja e të dhënave për këtë studim është kryer përmes një sërë teknikash, duke filluar nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë deri te grupet fokale/referencë dhe intervistat gjysmë të strukturuar. Analiza ndërtohet mbi triangulimin e informacionit të marrë nga perspektivat e aktorëve të ndryshëm, si dhe mbi të dhëna dhe dokumentacion dytësor të rishikuar nga ekspertët e vlerësimit.

Ky studim bazohet në tri aktivitete kryesore:

1. Përfshirja e aktorëve të interesuar;

2. Shqyrtimi i dokumenteve të politikave dhe programeve si dhe kuadrit që lidhet me skemën e aftësisë së kufizuar;

3. Mbledhja e të dhënave.

**Përfshirja e aktorëve të interesuar:** Janë zhvilluar takime me aktorët kryesorë, veçanërisht me ekipin e TFL dhe aktorë të tjerë kyç, si organizatat kryesore joqeveritare që veprojnë në sektorin e aftësisë së kufizuar dhe të drejtave të njeriut. Qëllimi i këtyre takimeve ishte të sigurohej një mundësi për aktorët kryesorë të marrin pjesë në hartimin, mbledhjen e të dhënave, analizën dhe zhvillimin e rekomandimeve.

**Shqyrtimi i dokumentacionit:** Hulumtimi fillestar përfshinte rishikimin e politikave dhe programeve ekzistuese, duke u fokusuar te dokumentet dhe kuadrot më të rëndësishme, kuadri ligjor, buxheti dhe të dhëna të tjera financiare, dhe u realizua nga ekipi i vlerësimit. Vëmendje të veçantë iu kushtua koordinimit të përpjekjeve nga të gjithë anëtarët e ekipit dhe rishikimit të integruar për të përmirësuar efikasitetin dhe për të shmangur punën e dyfishtë. Hulumtimi ligjor dhe rregullator ka vlerësuar legjislacionin në masën që lidhet me “Vlerësimin e Efekteve të Skemës së Re të Aftësisë së Kufizuar” dhe objektivat e punës.



**Mbledhja e të dhënave / Intervista me palët e interesuara me pyetësorë gjysmë të strukturuar:** Këto intervista u zhvilluan duke respektuar një sërë masash të qëndrueshme për pëlqimin e informuar dhe konfidencialitetin. Në to morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe nga institucione të pavarura, si Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe ndër të tjera Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Informacione dhe të dhëna shtesë<sup>8</sup> u ofruan nga institucionet përgjegjëse në përgjigje të kërkesës sonë për informacion.

Ju lutemi referojuni **Tabelës 1** për më shumë detaje mbi gamën e aktorëve të intervistuar për qëllimet e këtij vlerësimi.

***Tabela 1 - Numri i intervistave gjysmë të strukturuar***

Lloji	Numri i të intervistuarve
Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar	1
Punonjësit përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar në Bashkinë e Tiranës	1
Punonjësit përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar në Bashkinë e Kamzës	1
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	0
Zyra e Avokatit të Popullit	2

[8] Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Ekonomisë; Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.



<b>Lloji</b>	<b>Numri i të intervistuarve</b>
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	1
Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale	1
Shërbimi Social Shtetëror	1
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	1
Qendra për Ndihmë Ligjore Falas	1
MEDPAK	1
Fondacioni “Së bashku”	1
<b>Totali</b>	<b>13</b>



**Anketa:** Të dhënat e anketës dhe përfundimet e nxjerra nga anketa e kryer nga MEDPAK në shtator 2025, me titull “Transparenca dhe llogaridhënia në vlerësimin bio-psiko-social: nga gjetjet te veprimi”,<sup>9</sup> janë përdorur nga ekipi i vlerësimit për këtë analizë, për të shmangur çdo dyfishim të përpjekjeve në mbledhjen e të njëjtave informacione dhe të dhëna primare.


**Kufizimet dhe rreziqet:** Ekzistojnë disa kufizime të rëndësishme në metodat e përdorura për këtë vlerësim. Së pari, për shkak të kohës dhe burimeve të kufizuara, nuk ishte e mundur të mbledheshin mostra përfaqësimi. Për rrjedhojë, vlerësimi është në thelb cilësor, i bazuar në mostra të vogla dhe jo të rastësishme. Megjithatë, rezultatet e anketës të realizuara nga MEDPAK përdoren si burimi kryesor i të dhënave për të mbledhur mendime nga personat me aftësi të kufizuara lidhur me zbatimin e modelit bio-psiko-social dhe skemës së pagesave, si dhe për të marrë kontribute nga punonjës të administratës qendrore dhe vendore që janë përgjegjës për çështjet që lidhen me aftësinë e kufizuar.

Ky vlerësim pranon rrezikun e subjektivitetit dhe paragjykit, që mund të lindë nga përdorimi i një ankete të realizuar nga një organizatë tjetër, e cila nuk është e fokusuar kryesisht në analizën sasiore. Gjithashtu, ky vlerësim nuk përfshin një analizë të punësimit dhe zhvillimit profesional të personave me aftësi të kufizuara, që përbën një nga shtyllat kryesore dhe përfitimet e synuara të modelit të ri bio-psiko-social, pasi Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) nuk ishte në dispozicion për të ofruar informacionin e nevojshëm. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së të dhënave të publikuara, nuk ishte e mundur të shqyrtohej rënia e raportuar e punësimit sipas skemës së re, e cila, sipas Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale, ka rënë nga 111 në vitin 2022, në 103 në vitin 2023, dhe më pas në 46 në vitin 2024.<sup>10</sup>

Vlerësimi ligjor është i lidhur me disa kufizime. Ai bazohet në disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave ekzistuese, legjislacionit dhe dokumenteve të politikave që lidhen me skemën e re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri. Analiza nuk merr parasysh reforma të papublikuara, joformale ose të vazhdueshme që mund të ndikojnë në zbatimin ose interpretimin e kuadrit ligjor përkatës. Për më tepër, vlerësimi i efektivitetit të politikave dhe programeve reflekton situatën në momentin e mbledhjes së të dhënave dhe mund të mos kapë plotësisht zhvillimet administrative ose gjyqësore pasuese. Prandaj, gjetjet duhet të interpretohen brenda këtyre kufizimeve kontekstuale dhe kohore.

[9] <https://medpak.al/botime/transparence-dhe-llogaridhenie-ne-vleresimin-bio-psiko-social-nga-gjetjet-ne-veprim/>

[10] [https://inspektoriaqipunes.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/ISHPSHSH\\_Raporti-Vjetor\\_2024.pdf](https://inspektoriaqipunes.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/ISHPSHSH_Raporti-Vjetor_2024.pdf)



# Pjesa 1

GJETJET &  
REKOMANDIMET  
KRYESORE  
EKONOMIKE  
DHE LIGJORE



**Gjetje 1:** Këshilli Kombëtar për Personat me aftësi të kufizuara (Këshilli) karakterizohet nga funksionim i parregullt, ndikim i kufizuar në procesin e vendimmarrjes dhe përfaqësim jo i mjaftueshëm gjithëpërfshirës. Rekomandimet e aktorëve të interesuar shpesh mbeten formalitete procedurale dhe nuk pasohen nga veprime apo mekanizma zbatimi nga institucionet përgjegjëse, veçanërisht në lidhje me vlerësimin bio-psiko-social.

Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara është një organ këshillimor i Qeverisë që shqyrton, koordinon dhe lehtëson veprimet lidhur me aftësinë e kufizuar ndërmjet sektorëve dhe në nivele të ndryshme të qeverisjes. Ai udhëhiqet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përbëhet nga 17 anëtarë, përfshirë 10 përfaqësues nga Kabineti i Qeverisë dhe 7 nga organizatat e personave me aftësi të kufizuara. Perspektivat e aktorëve nga shoqëria civile, së bashku me rishikimin tonë të të dhënave dytësore, tregojnë se Këshilli nuk ka kontribuar në mënyrë efektive në përmirësimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe në sigurimin që zëri i organizatave të shoqërisë civile dhe i individëve të dëgjohej dhe të reflektohet në proceset e vendimmarrjes. Këshilli nuk ka funksionuar rregullisht, siç kërkohet nga ligji. Janë zhvilluar vetëm një numër i kufizuar takimesh, dhe “diskutimet janë përqendruar kryesisht tek agjenda propagandistike dhe politike e qeverisë. Anëtarëve nga organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë personat me aftësi të kufizuara nuk iu është dhënë mundësia të shprehin shqetësimet e tyre ose të diskutojnë zgjidhje të mundshme dhe plane veprimi” – deklaroi një aktor nga organizatat e shoqërisë civile. Për më tepër, transparenca ka qenë e kufizuar për shkak të mungesës së publikuar rregullisht të rendit të ditës dhe procesverbalëve të takimeve. Raporti i Auditimit të Performancës *“Aksesueshmëria për Personat me Aftësi të Kufizuar” 2025 i Kontrollit të Lartë të Shtetit gjithashtu trajton këtë gjetje<sup>11</sup>. Raporti thekson se: “Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk ka funksionuar rregullisht ose në mënyrë efektive si një organ këshillues dhe vlerësues ndër-institucional, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM Nr. 48, datë 21.01.2015. Gjatë periudhës 2021–2024, janë mbajtur vetëm tre takime, përfshirë një takim online pa dokumentacion mbështetës. Përfaqësimi institucional nuk ishte në nivel ministerial, siç parashikohet nga kuadri ligjor, dhe rastet e delegimit nuk ishin dokumentuar sipas kërkesave të Kodit të Procedurave Administrative. Për më tepër, temat e trajtuara në takime ishin të përgjithshme dhe nuk përfshinin çështje kyçe si aksesueshmëria në infrastrukturë dhe transport. Këto mangësi kanë kufizuar rolin udhëheqës dhe koordinator të këshillit në fushën e politikave për personat me aftësi të kufizuar.”*

[11] [https://www.klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/11/Raport-Aksesueshmëria-PAK-web.pdf?utm\\_](https://www.klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/11/Raport-Aksesueshmëria-PAK-web.pdf?utm_)



**Rekomandim 1:** Të forcohet mbikëqyrja institucionale duke siguruar që Këshilli Kombëtar për Personat me aftësi të kufizuara të funksionojë në mënyrë efektive. Ai duhet të mblidhet të paktën dy herë në vit, të përfshijë përfaqësimit të larmishëm dhe aktiv nga shoqëria civile dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndjekë një plan të qartë vjetor pune. Nevojiten mekanizma transparentë për të ndjekur, zbatuar dhe raportuar publikisht mbi rekomandimet, të mbështetura nga procesverbalet e publikuara dhe raportet e monitorimit. Vlerësimet e rregullta të ndikimit të Këshillit do të ndihmonin në forcimin e vendimmarrjes bazuar në prova dhe përmirësimin e politikave për personat me aftësi të kufizuara.

## STRATEGJIKE

**Gjetje 2:** Ekziston një mungesë transparence në lidhje me përfitimet dhe sfidat e projektit pilot të zbatuar në tre qarqe për të prezantuar skemën e re bio-psiko-sociale, si dhe mënyrën se si këto sfida u adresuan kur skema u zgjerua në nivel kombëtar. Gjithashtu, mungon qartësia dhe nuk ka prova të disponueshme që tregojnë se është kryer një vlerësim i kapaciteteve, burimeve njerëzore, aksesueshmërisë, duke përfshirë banesat dhe ambientet e tjera të kujdesit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe nevojave të përgjithshme, para kalimit nga modeli i vjetër mjekësor tek skema e re bio-psiko-sociale.

Reforma synon të zbatojë qasjen bio-psiko-sociale, e cila e sheh aftësinë e kufizuara jo vetëm si një gjendje mjekësore, por si rezultat i ndërveprimeve midis faktorëve biologjikë, psikologjikë dhe socialë. Sipas gjetjeve nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe praktikave dhe ankesave të shqyrtuara nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk duket se është kryer ndonjë analizë e plotë e realiteteve sociale, ekonomike, institucionale dhe strukturore të Shqipërisë para zbatimit të reformës. Kërkuam qasje në gjetjet zyrtare të projektit pilot të zhvilluar në Tiranë, Durrës dhe Elbasan, por nuk arritëm të gjenim ndonjë raport zyrtar. Organizatat e shoqërisë civile kanë shprehur shqetësime për mungesën e qartësisë lidhur me përparimin e reformës. Nuk janë publikuar raporte monitorimi publike që të përshkruajnë arritjet dhe sfidat në procesin e vlerësimit. Kjo mungesë transparence jo vetëm që errëson vlerësimin e kapaciteteve në nivelet e qeverisjes qendrore dhe lokale për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, por gjithashtu kufizon angazhimin qytetar dhe redukton mundësitë për qytetarët që të kontribuojnë në përmirësimin e sistemit.



**Rekomandim 2:** Të rritet transparencja dhe llogaridhënia publike duke vendosur rezultate dhe tregues të qartë, si dhe duke publikuar rregullisht raporte monitorimi dhe vlerësimi mbi reformën, duke përfshirë përparimin në rezultatet kryesore, sfidat dhe ankesat. Të krijohen mekanizma dhe mjete që lejojnë shoqërinë civile dhe aktorët e tjerë relevantë të marrin pjesë në mënyrë të vlefshme në mbikëqyrje dhe përmirësim të vazhdueshëm të sistemit.

**Gjetje 3:** Perspektivat e shumicës së aktorëve tregojnë se kapacitetet dhe shërbimet e ofruara për personat me aftësi të kufizuara janë shpesh më të ulëta se ato të rekomanduara nga Komisioni Multidisiplinar. Ekziston një mungesë harmonizimi dhe kohezioni midis institucioneve qendrore dhe lokale, veçanërisht në aspektin e aftësive dhe kohës së burimeve njerëzore, si dhe të infrastrukturës që nuk korrespondon me nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Kjo ngre shqetësime mbi efektivitetin praktik të zbatimit të qasjes bio-psiko-sociale. Një shqetësim i madh i ngritur nga aktorët kyç është mungesa e konsiderueshme e qendrave për shëndetin mendor, të cilat mbeten kryesisht të pazhvilluara në shumë qytete dhe bashki të Shqipërisë.


*“Shumë shërbime të rekomanduara nga Komisionet Multidisiplinare nuk ofrohen nga Qendrat e Komunitetit në Njësitë Administrative përkatëse,”* – deklaroi një përfaqësues i Bashkisë Tiranë.

Anëtarët e këtyre Komisioneve e pranuan këtë gjatë intervistave, por shpjeguan se rekomandimet e tyre bazohen në Manualët zyrtarisht të miratuara për Vlerësimin Bio-psiko-social të Aftësisë së Kufizuar tek të Rriturit dhe Fëmijët. Ata theksuan se *“nuk mund të heqin dorë nga dhënia e rekomandimeve të duhura. Është përgjegjësi e bashkive dhe shërbimeve sociale lokale të alokojnë fondet dhe të sigurojnë ofrimin e këtyre shërbimeve.”*

Rezultatet e anketës së MEDPAK gjithashtu tregojnë se 80% e personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre ndihen se nuk ekzistojnë ambientet e përshtatshme ose infrastruktura e mjaftueshme kur Komisioni vlerëson nevojat e tyre. Për më tepër, të intervistuarit raportuan se ofruesit e shërbimeve nuk përdorin gjuhë të specializuar ose mjete të përshtatura gjatë kryerjes së vlerësimit bio-psiko-social. Gjithashtu, sipas gjetjeve lidhur me komunikimin me profesionistët e shëndetit që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara, 38% raportuan një përvojë të mirë, 21% raportuan shërbime të dobëta, dhe 42% deklaruan se nuk kishte komunikim fare me institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara. Kjo mungesë komunikimi kontribuon në koordinim të dobët dhe minon përpjekjet për të siguruar ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse.



**Grafiku 1:** Si ndiheni në lidhje me komunikimin me profesionistët e shëndetësisë?



Kjo situatë evidenton një mungesë koordinimi efektiv midis institucioneve qendrore dhe lokale, shërbimeve sociale, ofruesve të shëndetësisë dhe organeve të tjera përkatëse, pavarësisht kornizës së vendosur nga Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030 dhe Plani i saj i Veprimit, e cila synon të sigurojë që shërbimet për personat me aftësi të kufizuara të jenë të aksesueshme, të përballueshme dhe të zbatuara në mënyrë efektive në praktikë.

**Rekomandim 3.1:** Të forcohen bazat analitike të modelit bio-psiko-social duke kryer një analizë kombëtare gjithëpërfshirëse të kontekstit shoqëror, ekonomik dhe territorial të Shqipërisë, si dhe të kapaciteteve ekzistuese. Duhet të integrohen tregues lokalë të rëndësishëm, si niveli i varfërisë, qasja në shërbime, barrierat mjedisore të stilit të jetesës dhe mbështetja familjare, brenda procesit të vlerësimit, për të siguruar një kuptim gjithëpërfshirës të qasjes.

**Rekomandim 3.2:** Nevojitet të kryhet një hartëzim gjithëpërfshirës i kapaciteteve, duke përfshirë infrastrukturën dhe burimet, në të gjithë vendin. Komisioni Multidisiplinar duhet të përcaktojë alternativat e përshtatshme, si shërbime alternative në natyrë ose kompensim financiar, në rastet kur institucionet publike ose ofruesit e shëndetit nuk kanë kapacitet për të ofruar shërbimet e kërkuara.



**Gjetje 4:** Brenda Komisionit Multidisiplinar ekziston një qasje e fragmentuar dhe e ndarë, kur vlerësohen nevojat përkatëse të personave me aftësi të kufizuara. Shpesh mungojnë inputet nga mjekët familjarë, specialistët, qendrat mjekësore që ofrojnë shërbime në natyrë dhe agjencitë e punësimit, gjë që çon në vendime të pasakta dhe të pasinkronizuara, madje edhe për aplikantë me të njëjtat kushte aftësie.

Mungesa e sistemeve dhe mjeteve të automatizuara e bën edhe më të vështirë për palët përkatëse të sigurojnë dhe të ruajnë informacionin në një sistem qendror. Kjo kufizon aftësinë e Komisionit Multidisiplinar për të bazuar vendimet mbi historikun e plotë të aplikantit dhe për të përdorur të dhënat e mbledhura për të prodhuar raporte të sakta mbi progresin e aplikantëve, si dhe për të identifikuar nevojat kombëtare lidhur me kapacitetet, shërbimet dhe infrastrukturën.

Qasja aktuale kërkon që personat me aftësi të kufizuara (aplikantët) të marrin pjesë në një intervistë me Komisionin Multidisiplinar, sipas afateve dhe frekuencës të përcaktuara nga vetë Komisioni. Përdoret një pyetësor i detajuar për të vlerësuar kapacitetet dhe aftësitë e aplikantit për të kryer aktivitetet e përditshme. Përgjigjet vlerësohen me pikë, dhe vendimi përfundimtar për kategorinë e aftësisë së kufizuar bazohet mbi këto pikë. Ky vendim përfshin jo vetëm përfitime monetare, por edhe mbështetje në natyrë, si terapi të të folurit, fizioterapi, trajnim dhe aktivitete zhvillimi profesional të destinuara për të ndihmuar aplikantin të rikthehet në punë.

Nga intervistat me palët e interesit, rezulton se qasja e ndjekur nga Komisioni Multidisiplinar është e izoluar dhe fragmentuar. Nuk ofrohet asnjë feedback sistematik nga mjekët familjarë, specialistët, qendrat publike apo private që ofrojnë shërbime në natyrë të rekomanduara nga Komisioni, apo nga agjencitë dhe punëdhënësit lidhur me mundësitë e punësimit ose performancën në punë të personave me aftësi të kufizuara. Si rezultat, vlerësimi i aplikantëve mbështetet thuhet në tërësi vetëm mbi një intervistë një-orëshe të kryer nga dy anëtarë të Komisionit Multidisiplinar. Palët e interesit shprehën shqetësimin se një qasje e tillë nuk çon në vlerësime të sakta dhe mund të rezultojë në rekomandime jo të përshtatshme, duke kufizuar në fund aftësinë e aplikantëve për të jetuar me më pak pengesa.

Gjithashtu, nuk është e qartë nëse Komisioni Multidisiplinar përdor një sistem të automatizuar që lejon të gjitha palët përkatëse të fusin informacion gjatë gjithë procesit të vlerësimit. Po ashtu, nuk dihet nëse një sistem i tillë, nëse ekziston, merr në konsideratë në mënyrë të mjaftueshme kërkesat për mbrojtjen e të dhënave sipas Ligjit nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe neneve të tij, duke përfshirë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara që informacioni i tyre të anonimizohet kur raportet lëshohen ose përgatiten për qëllime statistikore.



Ekzistenca e një mjeti të tillë do të reduktonte fragmentimin, do të minimizonte rrezikun e dokumentacionit të paplotë ose të pasinkronizuar, dhe do të mbështeste vendimmarrje më objektive dhe të bazuar në dëshmi.

**Rekomandim 4.1:** Të forcohet bashkëpunimi ndër-institucional duke formalizuar koordinimin dhe kontributet e të gjithë aktorëve të përfshirë në vlerësimin dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë mjekët familjarë, klinikat specialistike, ofruesit e kujdesit shëndetësor primar dhe shërbimet e tjera mjekësore që ofrojnë mbështetje në natyrë, si dhe administratorët socialë që ndjekin nga afër progresin e individëve me aftësi të kufizuara.

**Rekomandim 4.2:** Të prezantohet një sistem i integruar i automatizuar që lejon të gjitha palët përkatëse, profesionistët mjekësorë, administratorët socialë, shërbimet e specializuara dhe Komisionet Multidisiplinare të Vlerësimit, të fusin informacionin direkt në një platformë të unifikuar. Një sistem i tillë do të sigurojë që çdo vlerësim të bazohet në një pasqyrë të plotë, të saktë dhe të përditësuar të nevojave, historikut dhe progresit të individit.

## OPERACIONALE

**Gjetje 5:** Administratorët socialë luajnë një rol jetik në zbatimin e qasjes bio-psiko-sociale dhe në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Megjithatë, efektiviteti i tyre është i kufizuar nga mungesa e burimeve, trajnimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e automatizimit dhe dokumentacionit të standardizuar. Këto mangësi e bëjnë punën e tyre joefikase, duke i detyruar të përqendrohen më shumë te detyrat burokratike sesa te mbështetja e drejtpërdrejtë e individëve, përfshirë informimin mbi të drejtat dhe përfitimet që u takojnë.


Administratorët socialë luajnë një rol qendror në procesin e vlerësimit bio-psiko-social për personat me aftësi të kufizuara. Roli i tyre përcaktohet në disa nene (4, 15, 16, 22 dhe veçanërisht 23) të Ligjit nr. 57/2019 “Për Ndihmën Sociale në Republikën e Shqipërisë” (me ndryshimet e mëvonshme) dhe në Seksionin III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 722. Detyrat kryesore të tyre përfshijnë: (i) Pjesëmarrja në Vlerësim: Bashkëpunimi me profesionistët mjekësorë për të vlerësuar kapacitetet funksionale, nevojat sociale dhe barrierat mjedisore të aplikantëve. (ii) Menaxhimi i Rastit:



Intervistat me palët e interesuara nxjerrin në pah disa kufizime dhe sfida që ndikojnë në rolin efektiv të administratorëve socialë në vlerësimin bio-psiko-social, duke përfshirë sa vijon:

**Kufizimet e Burimeve:** Shumë administratorë socialë, veçanërisht ata që punojnë në zonat rurale dhe periferike, përballen me mungesa të stafit të kualifikuar, mjeteve thelbësore dhe infrastrukturës së mjaftueshme. Këto kufizime reduktojnë ndjeshëm kapacitetin e tyre për të kryer vlerësime të sakta dhe gjithëpërfshirëse. Në praktikë, kjo do të thotë se në disa raste ata nuk janë në gjendje të kryejnë vizita në shtëpi të paktën një herë çdo tre muaj, siç kërkohet nga Neni III, pika 5 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 722. Gjithashtu, sipas sektorit të Mbrojtjes Sociale të Bashkisë Tiranë, “aftësitë e kufizuara ndonjëherë raportohen nën nivelin real për shkak të stigma-s brenda familjeve, veçanërisht në rastet që përfshijnë fëmijë me spektrin e autizmit”. Një administrator social shpjegoi: “Ka 430 individë me aftësi të kufizuara në zonën time. Ligji kërkon që të vizitohet secilin prej tyre çdo tre muaj, kryesisht për të verifikuar vendbanimin, por edhe për të vlerësuar progresin e tyre. Për të përmbushur këtë kërkesë ligjore, do të duhej të vizitohet shtatë familje çdo ditë, gjë që nuk do të lejonte asnjë kohë në zyrë. Kjo thjesht nuk është e realizueshme duke marrë parasysh kapacitetin tonë të kufizuar. Për më tepër, kam detyra të tjera administrative, si përgatitja e përditësimeve mujore për shërbimet sociale mbi progresin e individëve me aftësi të kufizuara, pjesëmarrja në trajnime, informimi mbi ndryshimet ligjore dhe përmbushja e detyrave të tjera të kërkuara ligjërisht. Nuk është praktikisht e mundur.” Rezultatet e sondazhit të MEDPAK gjithashtu tregojnë se shumica e profesionistëve që punojnë në fushën e aftësisë së kufizuar besojnë se vlerësimi bio-psiko-social nuk mbështetet mjaftueshëm nga burimet financiare dhe njerëzore. Konkretisht, 65% e të anketuarve raportuan mungesë të fondeve të mjaftueshme, ndërsa 25% shprehën pasiguri mbi disponueshmërinë e burimeve.

**Grafiku 2: Mjaftueshmëria e burimeve financiare**





**Trajnim i Pamjaftueshëm:** Mungesa e zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe e mundësive për trajnime të avancuara kufizon aftësinë e administratorëve socialë për të kryer në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme vlerësime komplekse bio-psiko-sociale. Në Bashkinë e Tiranës nuk ekziston një skemë e strukturuar trajnimi për administratorët socialë. Për më tepër, ata nuk disponojnë një dokument udhëzues apo manual që trajton specifikisht vlerësimin dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, duke theksuar nevojën për trajnime rifreskuese të vazhdueshme në këtë fushë. Ky qëndrim mbështetet nga rezultatet e sondazhit të MEDPAK, të cilat tregojnë se vetëm një numër i kufizuar i të anketuarve ka raportuar se ka marrë ndonjë trajnim.

Një tjetër administrator social konfirmoi se ata marrin trajnim një herë në vit, ku më i fundit është financuar nga UNDP. Megjithatë, kur kërkua informacion mbi modulat e trajnimit dhe listën e administratorëve socialë të trajnuar në çdo qytet, bashki ose rajon, Ministria e Shëndetësisë nuk ofroi një informacion të tillë. Megjithëse trajnimet fillestare mund të mos jenë të nevojshme për stafin me përvojë, trajnimet rifreskuese duhet të jenë të detyrueshme për të siguruar që ata që punojnë në një fushë kaq komplekse të jenë të përditësuar me ndryshimet ligjore dhe të njohin praktikat më të mira ndërkombëtare për zbatimin efektiv të qasjes bio-psiko-sociale.


### **Mungesa e Automatizimit dhe e Standardizimit të Dokumentacionit:**

Procedurat ekzistuese të vlerësimit kërkojnë dokumentacion të gjerë, i cili mund të jetë i vështirë për t'u siguruar, i paplotë ose i standardizuar në mënyrë jo të qëndrueshme, veçanërisht në zona me burime të kufizuara. Vlerësimet e kryera gjatë vizitave në shtëpi regjistrohen manualisht, pasi nuk ekziston një Formular Standard i cili i lejon Administratorët Socialë të dokumentojnë komente dhe vëzhgime, dhe mbetet e paqartë se si këto informacione të mbledhura manualisht transferohen më pas në Regjistrin Kombëtar Elektronik. Kjo ngre shqetësime për efikasitetin dhe besueshmërinë e procesit në tërësi. Për më tepër, nuk ka prova që të konfirmojnë se rezultatet dhe ndjekja e rekomandimeve të mëparshme për terapi të folurit dhe fizioterapi të lëshuara nga Komisionet dokumentohen ose monitorohen në mënyrë të duhur.

Gjithashtu, rezultatet e sondazhit të MEDPAK konfirmojnë se ekziston hapësirë për përmirësim në lidhje me standardizimin e manualeve dhe udhëzimeve, si dhe nevojën për komunikim më të qartë dhe trajnime të vazhdueshme mbi politikën dhe procedurat e vlerësimit bio-psiko-social. Sipas sondazhit, 25% e të anketuarve raportuan mungesën e udhëzimeve të standardizuara dhe përdorimin jo të qëndrueshëm të instruksioneve, ndërsa 35% nuk ishin të sigurt nëse një protokoll i tillë ekziston.



**Grafiku 3:** Standardizimi i manualeve dhe udhëzimi mbi vlerësimin biopsikosocial



**Rekomandim 5.1:** Të alokohet staf shtesë, mjetet e nevojshme dhe transport i dedikuar ose njësitë mobile të vlerësimit për të lehtësuar vizitat në shtëpi nga administratorët socialë të paktën çdo tremujor, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 722.

**Rekomandim 5.2:** Të zhvillohet dhe zbatohet një program i strukturuar i zhvillimit profesional të vazhdueshëm për administratorët socialë, duke përfshirë trajnime mbi përfitimet dhe sfidat e qasjes bio-psiko-sociale. Trajnimi duhet të përfshijë mësim praktik të bazuar në raste konkrete dhe udhëzime praktike mbi komunikimin etik, respektues dhe empatik me personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

**Rekomandim 5.3:** Të hartohet dhe shpërndahej një manual i plotë ose një grup procedurash standarde operacionale për administratorët socialë, duke përshkruar qartë të gjitha fazat e procesit të vlerësimit, pritshmëritë për vizitat në shtëpi dhe kërkesat e detajuara për raportim për personat me aftësi të kufizuara. Ky manual duhet të përmbajë udhëzime hap pas hapi, shembuj praktikë, standarde të komunikimit etik dhe udhëzime për përgatitjen për vizitat në shtëpi, angazhimin respektues me personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, si dhe dokumentimin e vëzhgimeve në mënyrë të strukturuar dhe objektive.

Të zhvillohen forma dhe template standarde për regjistrimin e komenteve nga vizitat në shtëpi të personave me aftësi të kufizuara, për të promovuar uniformitetin dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore. Standardizimi gjithashtu do të mbështesë sigurimin e cilësisë dhe do të përmirësojë besueshmërinë e të dhënave që përdoren për marrjen e vendimeve dhe zhvillimin e politikave.



**Rekomandim 5.4:** Të krijohet një sistem elektronik për ndjekjen e të dhënave të vlerësimit, duke ulur rrezikun e dokumentacionit të paplotë ose të pasaktë dhe duke siguruar integrimin e plotë me Regjistrin Kombëtar Elektronik. Ky sistem duhet të funksionojë si një platformë qendrore dhe e sigurt ku administratorët socialë mund të fusin informacion në kohë reale. Duke konsoliduar të dhënat në një regjistër digjital të vetëm, sistemi do të minimizojë gabimet njerëzore duke ofruar fusha të detyrueshme dhe alarme të automatizuara kur informacioni mungon ose është i vjetëruar. Në një fazë të avancuar, analiza e integruar mund të ndihmojë në identifikimin e trendeve, sinjalizimin e rasteve komplekse për rishikim të mëtejshëm nga komisionet multidisiplinare dhe mbështetjen e planifikimit afatgjatë në nivel politikash. Në fund, një sistem i tillë do të përmirësojë transparencën, forcimin e llogaridhënies dhe do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të marrin mbështetje në kohë dhe të informuar mirë.

**Gjetje 6: Edhe pse i përfshirë në kuadrin ligjor që nga viti 2023, Fondi Social i Punësimit, i destinuar për të promovuar punësimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, ende nuk është aktivizuar ose zbatuar në praktikë.**

Fondi Social i Punësimit është një mekanizëm politikash i vendosur sipas nenit 21 të ligjit nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit” (i ndryshuar). Ai ka për qëllim të mbështesë përfshirjen në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara,<sup>12</sup> duke financuar masa të lidhura me punësimin, si trajnime, adaptim të vendit të punës dhe zhvillim të aftësive. *“Fondi krijohet nga financime dhe grante; fonde të siguruar nga marrëveshjet midis Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe donatorëve të ndryshëm; buxheti i shtetit dhe burime të ligjshme, dhe më e rëndësishmja, nga kontributet e paguara në llogarinë e Fondit nga punëdhënësit. Sipas nenit 20 të ligjit, punëdhënësit duhet të punësojnë një person me aftësi të kufizuara për çdo 25 punonjës të parë të ndërmarrjes dhe një person shtesë për çdo 50 punonjës shtesë. Punëdhënësit që nuk punësojnë numrin e kërkuar të personave nga grupet e përcaktuara duhet të paguajnë një kontribut të barabartë me pagën minimale kombëtare për person në muaj në Fondin Social të Punësimit. Paga bëhet përmes sistemit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe procedura duhet të ishte standardizuar nga një Udhëzim i veçantë i Ministrit të Financave brenda datës 31 dhjetor 2023.”*

<sup>[12]</sup> Neni 3, pika 4, paragrafi c): “Personat me aftësi të kufizuara, përfshirë personat shurdhë dhe individët me aftësi të kufizuara për punë, të cilët vlerësohen si pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse.”



Analiza jonë tregon se Fondi Social i Punësimit ende nuk është funksional, dhe Udhëzimi përkatës i Ministrisë së Financave nuk është miratuar ende. Ne kemi ftuar Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, e cila gjithashtu mbikëqyr portofolin e punësimit, për të dhënë koment mbi këtë çështje, por nuk është marrë asnjë përgjigje.

**Rekomandim 6:** Të zbatohet dhe të vihet në funksion një Fond i Dedikuar Social i Punësimit për të mbështetur përfshirjen në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara, duke financuar masa të lidhura me punësimin, si trajnime profesionale, adaptime në vendin e punës dhe zhvillim të aftësive. Ky Fond mund të mbështesë iniciativa të tilla si mentorim profesional, skema të punësimit të mbështetur, grante sipërmarrëse për personat me aftësi të kufizuara, si dhe stimuj për punëdhënësit që demonstrojnë praktika përfshirëse të punësimit.


**Gjetje 7:** Ekziston perceptimi midis aktorëve kryesorë se klasifikimi i aftësive të kufizuara vazhdon të bazohet kryesisht në diagnoza mjekësore. Kjo vazhdon pavarësisht qëllimit të modelit të ri, i cili promovon një kuptim gjithëpërfshirës të shëndetit dhe sëmundjes duke marrë parasysh jo vetëm faktorët biologjikë, por edhe aspektet psikologjike, si mendimi dhe sjellja.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka hetuar disa raste që përfshijnë individë të cilët u përjashtuan nga skema e pagesave pas futjes së vlerësimit bio-psiko-social dhe të cilëve nuk u ofruan shërbime alternative. Për shembull, ka pasur ankesa nga persona me diabet të cilët janë përjashtuar nga skema. Këto ankesa shpesh shprehen në formën e pyetjeve të thjeshta, si: “Ne më parë ishim përfitues, dhe tani nuk jemi.” Ndërsa Komisioneri ka dhënë shpjegime në lidhje me parimet e skemës së re, institucioni nuk mund të sfidojë diagnozat mjekësore të lëshuara nga Komisionet Multidisiplinore për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar – u shpreh Komisioneri.

Rezultatet e sondazhit të MEDPAK gjithashtu tregojnë se të anketuarit përjetuan vështirësi në kuptimin e komponentëve psikologjikë dhe socialë të vlerësimit. Gjysma e të anketuarve (50%) raportuan sfida që lidhen me dimensionin psikologjik të modelit, kryesisht për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të psikologëve dhe punonjësve socialë. Një tjetër 25% raportuan vështirësi me aspektin mjekësor të vlerësimit, duke përfshirë terminologji mjekësore të pasqaruar ose tepër komplekse dhe pasiguri lidhur me dokumentacionin mbështetës të kërkuar. Për më tepër, 20% theksuan mungesën e koherencës dhe koordinimit brenda Komisioneve Multidisiplinore.




**Grafiku 4:** Cilën pjesë të vlerësimit e konsideroni më sfiduese?



Për më tepër, shumë aktorë në sektorin e aftësive të kufizuara raportojnë se diagnozat mjekësore vazhdojnë të luajnë një rol vendimtar në përcaktimin e kategorive të aftësisë dhe përfitimeve përkatëse. Siç theksojnë ata, “Vlerësimet nga Komisioni Multidisiplinor shpesh bazohen vetëm në përqindjen e paaftësisë, pa marrë parasysh mjaftueshëm ndikimin e barrierave sociale në funksionimin e individit.” Kjo qasje çon në një mospërputhje midis nevojave reale të një personi dhe mbështetjes financiare që ai merr.

Kur MEDPAK pyeti personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre për ndonjë aktivitet edukativ të ofruar mbi modelin bio-psiko-social, 90% e të anketuarve raportuan se nuk kishin marrë asnjë trajnim apo pjesëmarrje në aktivitete komunikimi që do t’u kishin ndihmuar të kuptonin përfitimet dhe sfidat e këtij modeli të ri.

**Grafiku 5:** A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim mbi modelin psikosocial?





**Rekomandim 7:** Nxitja e një ndryshimi të qartë nga një qasje e bazuar vetëm në diagnoza drejt një kuptimi gjithëpërfshirës, bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, duke investuar në ndërgjegjësim, trajnim dhe praktikë të qëndrueshme në të gjitha nivelet e sistemit të vlerësimit. Kjo duhet të përfshijë fushata të synuara komunikimi për profesionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe organet monitoruese, për të shpjeguar se klasifikimi i aftësisë nuk përcaktohet më vetëm nga diagnozat mjekësore, por nga mënyra se si gjendjet shëndetësore ndërveprojnë me faktorët psikologjikë, sjelljen dhe barrierat sociale. Programet e trajnimit për vlerësuesit, stafin mjekësor, administratorët socialë dhe aktorët e tjerë përkatës të procesit duhet të theksojnë vlerësimin funksional, përvojën e jetuar dhe faktorët kontekstualë, duke ndihmuar aktorët dhe praktikantët të largohen nga një qasje e ngushtë klinike. Mjetet e standardizuara, shembujt praktik dhe udhëzimet për marrjen e vendimeve mund të forcojnë këtë ndryshim në praktikën e përditshme.

**Gjetje 8:** Ekzistojnë të dhëna kontradiktore të dhëna nga institucione të ndryshme qeveritare, si Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Inspektorati Shtetëror i Punës, gjë që krijon konfuzion mbi situatën reale të punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Për më tepër, nuk arritëm të siguronim të dhëna primare mbi progresin e punësimit ose mbi strategjitë e ardhshme për përmirësimin e rezultateve të punësimit për personat me aftësi të kufizuara, për shkak të kapacitetit të kufizuar të stafit të AKPA-së për të marrë pjesë në intervistat tona.

Ekzistojnë të dhëna kontradiktore të raportuara nga institucione të ndryshme shtetërore në lidhje me punësimin që nga viti 2020.

Sipas Inspektoratit Shtetëror të Punës, niveli i punësimit ka rënë gjatë tre viteve të fundit, duke u ulur thuajse gjysmë në vitin 2024 vetëm. Ata e atribuojnë këtë ulje në mosdeklarimin nga punëdhënësit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, për të shmangur në mënyrë të paligjshme pagesat e sigurimeve shoqërore.

Gjithashtu, punonjësit shpesh pranojnë këtë situatë nga frika se mund të humbasin ose të ulen përfitimet e tyre për aftësi të kufizuara nëse punësimi i tyre shpallet zyrtarisht. Megjithatë, Inspektorati i Punës inspekton vetëm rreth 7% të të gjithë punëdhënësve në Shqipëri, që do të thotë se këto gjetje bazohen vetëm në mostrën e kufizuar të përshkruar më sipër.



**Tabela 2:** Inspektorati i Punës - Punësimi i personave me aftësi të kufizuara

<b>Inspektorati i Punës</b>		
Punësimi i personave me aftësi të kufizuara		
2022	2023	2024
111	103	46

Nga ana tjetër, AKPA raporton të dhëna më optimiste lidhur me shkallën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Sipas AKPA, numri i individëve të punësuar u rrit nga 32 në vitin 2021 në 379 në vitin 2024. Detaje shtesë që konfirmojnë këtë trend rritës paraqiten në tabelën më poshtë. Për më tepër, bazuar në shkallën e zbatimit të buxhetit, realizimi faktik kundrejt atij të planifikuar për vitin 2020 ishte vetëm 61%, me 80 punonjës të planifikuar për t'u punësuar, por vetëm 49 persona me aftësi të kufizuara ishin të punësuar aktualisht atë vit. Ne nuk arritëm të aksesojmë të dhënat më të fundit mbi zbatimin e buxhetit për shkak të mungesës së statistikave të publikuara.


Pavarësisht kërkesave tona të shumta për një takim me AKPA për të diskutuar të dhënat e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, modulët e trajnimit dhe kurrikulat, të dhënat mbi numrin e personave të trajnuar dhe numrin e punëdhënësve që kanë adoptuar rregullime të veçanta, AKPA i refuzoi kërkesat tona. Si rezultat, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse trendi i punësimit është në rritje apo në rënie, as nuk mundëm të diskutojmë hapat e ardhshëm, strategjitë e punësimit, apo incentivat e mundshme për punëdhënësit për të punësuar më shumë persona me aftësi të kufizuara dhe për t'u njohur për praktikatat e tyre gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme.

**Tabela 3 :** AKPA- Punësimi i personave me aftësi të kufizuara

<b>AKPA</b>		
Punësimi i personave me aftësi të kufizuara		
2021	2022	2023
32	18	290



**Grafiku 6:** AKPA- Punësimi i personave me aftësi të kufizuara



**Burimi:** AKPA

Po ashtu, mungojnë të dhënat mbi numrin absolut të personave me aftësi të kufizuara që janë të punësuar, shkallën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara (numri i personave me aftësi të kufizuara të punësuar i ndarë me numrin total të personave me aftësi të kufizuara), dhe diferencën midis shkallës së punësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe atyre jo të aftë (e njohur si hendeku i punësimit të personave me aftësi të kufizuara). Statistikat e publikuara nga Eurostat tregojnë se në Bashkimin Evropian, hendeku i punësimit i personave me aftësi të kufizuara në vitin 2024 ishte 24 pikë përqindjeje. Si rezultat, është e vështirë të vlerësohet situata e punësimit të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri pas reformës së zbatuar në 2019, si dhe të matet përparimi në përmirësimin e rezultateve të punësimit për këtë grup, që përbën një nga komponentët kyç të Strategjisë për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025, dhe të krahasohet me statistikat e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në vendet e tjera.

**Rekomandim 8.1:** Të mblidhen dhe të publikohen të dhëna të sakta mbi personat me aftësi të kufizuara. Më konkretisht, statistikat duhet të përfshijnë, ndër të tjera:

- Numrin e personave me aftësi të kufizuara të punësuar
- Shkallën e punësimit të personave me aftësi të kufizuara
- Hendekun e punësimit të personave me aftësi të kufizuara për moshat pune 16–65 vjeç
- Numrin e personave me aftësi të kufizuara në raport me popullsinë në moshë pune
- Ndryshimet në hendekun e punësimit me moshën



- Shkallën e punësimit të grave me aftësi të kufizuara krahasuar me burrat me aftësi të kufizuara

**Rekomandim 8.2:** Të hartohet një plan veprimi brenda strategjisë së re kombëtare për të bërë botën e punës më gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme, duke vendosur propozime që u mundësojnë personave me aftësi të kufizuara jo vetëm të fillojnë, por edhe të qëndrojnë në punë; të inkurajohen punëdhënësit të punësojnë, të mbajnë dhe të promovojnë punonjësit e tyre me aftësi të kufizuara dhe të krijojnë vende pune gjithëpërfshirëse duke ofruar përshtatje të arsyeshme; të forcohen të drejtat në vendin e punës duke inkurajuar punën fleksibile dhe duke përmirësuar aksesin në këshilla mbi të drejtat e punës për personat me aftësi të kufizuara dhe punëdhënësit; të eksploroheret me personat me aftësi të kufizuara se çfarë ndihme shtesë do të ishte më e dobishme për ata që dëshirojnë të fillojnë një biznes; të mbështeten mundësitë për personat me aftësi të kufizuara në Shërbimin Civil dhe të sigurohet mbështetje për të arritur sukses në punë.

## LIGJORE

**Gjetje 9:** Para Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara kërkohet si rregull paraqitja fizike e personit me aftësi të kufizuara, madje edhe në raste kur individi ndodhet në një situatë të pamundur reale për t'u paraqitur (për shkak të dëmtimeve fizike ose psikomotore, diagnozave të avancuara të shoqëruara me gjendje të rënda, etj.). Ky standard nuk është i përputhshëm me parimet e kuadrit të vlerësimit bio-psiko-social. Ekziston një paqartësi midis akteve të ndryshme ligjore, e cila çon në praktikë në konfuzion mbi kërkesën e detyrueshme për praninë fizike të aplikantit para Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara. Në rastet e aftësive të kufizuara të rënda, kjo kërkesë krijon vështirësi logjistike të konsiderueshme dhe shpenzime shtesë, veçanërisht për individët që jetojnë në zona rurale me mundësi të kufizuara transporti. Për më tepër, nuk është alokuar asnjë buxhet për të mbuluar shpenzimet e anëtarëve të Komisioneve Multidisiplinare të Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara për të vizituar aplikantët në vendbanimin e tyre kur këto vizita janë të nevojshme.



Informacionet e nxjerra nga intervistat me përfaqësues të Qeverisë tregojnë se paraqitja fizike e personave me aftësi të kufizuara para Komisionit konsiderohet thelbësore në të gjitha rastet. Sipas këtyre institucioneve, pranimi fizik siguron një vlerësim të saktë bio-psiko-social, të kryer në mënyrë transparente dhe efektive, parandalon praktika abuzive, mundëson verifikimin nëse individit banon në adresën e deklaruar në Republikën e Shqipërisë, dhe konfirmon diagnozën e deklaruar bazuar në dokumentacionin e përgatitur nga mjeku familjar, mjeku specialist dhe profesionistë të tjerë të fushës mjekësore.

Megjithatë, analiza jonë e legjislacionit ekzistues tregon se paraqitja fizike e personave me aftësi të kufizuara para Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara nuk kërkohet shprehimisht si standard nga legjislacioni primar. Konkretisht, Ligji Nr. 57/2019, “Për Ndhimën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Neni 17, paragrafi 1, parashikon se: “pagesat lidhur me aftësitë e kufizuara jepen bazuar në vendimin e komisioneve të referuara në Nenin 8 të Ligjit, të cilat vlerësojnë aftësitë brenda kompetencave të tyre përkatëse. Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për vlerësimin dhe dhënien e pagesave për personat me aftësi të kufizuara, si dhe për ndihmësit e tyre personalë, përcaktohen nga një vendim i Këshillit të Ministrave.”

Nga ana tjetër, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 722, datë 11.11.2019, Seksioni III, pika 1, parashikon: *“procesi i vlerësimit bio-psiko-social përfshin: ....një intervistë me aplikantin në zyrën e vlerësimit të aftësive të kufizuara, e kryer nga Komisioni Multidisiplinar i Vlerësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara, i përbërë nga mjekë dhe punonjës socialë,...”*. Bazuar në këtë dispozitë, paraqitja fizike e aplikantit duket se është e detyrueshme në të gjitha rastet, me vetëm një përjashtim të implikuar. Formulari i Aplikimit, Vlerësimi Mjekësor për Përcaktimin e Aftësisë nga Mjeku Specialist, e miratuar si aneks në VKM Nr. 722, në pikën 9, parashikon se: *“Mjeku specialist mund të rekomandojë që vlerësimi për dhënien e statusit të aftësisë të kryhet në vendbanimin e aplikantit, duke marrë parasysh shkallën e dëmtimit të funksioneve dhe strukturave trupore.”*

Standardi i vendosur nga VKM-ja nuk është plotësisht në përputhje me parimet e kuadrit të vlerësimit bio-psiko-social. Në praktikë, ka individë me aftësi të kufizuara të rënda, ata që nuk kanë kapacitet juridik, nën kujdestari, ose me diagnoza të konfirmuara, të qëndrueshme dhe të pakthyeshme, për të cilët paraqitja fizike para Komisionit jo vetëm që nuk është e nevojshme, por mund të ndikojë negativisht në mirëqenien e tyre dhe të anëtarëve të familjes.



Për më tepër, ka raste ku ky kërkesë krijon vështirësi logjistike për individët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, duke sjellë kosto të larta dhe shpesh të papërbalueshme, veçanërisht për personat që jetojnë në zona rurale me transport të vështirë, në kushte sociale të ndërlikuara dhe pa të afërm të afërt për t'i shoqëruar.

Ky problem u diskutua gjithashtu me anëtarët e Komisioneve Multidisiplinare, të cilët vërejtën se në raste të tilla të rënda ata kryejnë vlerësime në shtëpitë ose qendrat e kujdesit të aplikantëve, pavarësisht mungesës së burimeve logjistike dhe financiare të nevojshme për të kryer intervistat në vendbanim.

**Rekomandim 9.1:** Të shtohen ndryshimet e nevojshme në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e shumës, kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për vlerësimin dhe dhënien e statusit të personave me aftësi të kufizuara dhe asistentit personal, si dhe strukturat përgjegjëse dhe detyrat e tyre,” për të lejuar që aplikantët – personat me aftësi të kufizuara, të intervistohen në vendbanimin e tyre kur shëndeti, kufizimet e lëvizshmërisë ose rrethanat personale e bëjnë të vështirë ose të pamundur pjesëmarrjen fizike në vlerësime. Ky ndryshim duhet të përcaktojë qartë kriteret e pranueshmërisë për intervistat në shtëpi, të skicojë përgjegjësitë e Komisioneve Multidisiplinare dhe të vendosë masa procedurale për të siguruar që vlerësimet në shtëpi kryhen me të njëjtin rigorozitet dhe dinjitet si ato të realizuara në ambientet e Shërbimit Social.

**Rekomandim 9.2:** Të sigurohen burimet logjistike, njerëzore dhe financiare të nevojshme që Komisionet Multidisiplinare të kryejnë dhe dokumentojnë si duhet intervistat jashtë ambientit të Shërbimeve Sociale. Kjo përfshin sigurimin e transportit, mjeteve të portabël për vlerësim dhe stafit të mjaftueshëm për të garantuar që vizitat në shtëpi të mos vonojnë procesin e përgjithshëm të vlerësimit.

**Gjetje 10:** Njoftimi i Vendimit të lëshuar nga Komisioni Mjekësor për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar nuk përfshin të gjitha elementët thelbësorë që kërkohen për një akt administrativ. Format i miratuar që përdoret aktualisht mungon në qartësi.

Sipas Nenit 99 të Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë,” një akt administrativ duhet të përfshijë qartë, ndër elementët e tjerë të kërkuar, bazën ligjore, arsyetimin e vendimit dhe gjykatën para së cilës mund të bëhet ankim.

Edhe pse Njoftimi i Vendimit të lëshuar nga Komisioni Mjekësor për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar identifikon qartë autoritetin administrativ, në përmbajtjen e vendimit mungojnë disa elementë kyç të kërkuar nga ligji, si vijon:




- i) e drejta për të apeluar te organi administrativ më i lartë,
- ii) baza ligjore mbi të cilën mbështetet vendimi (duke përfshirë nenin përkatës të ligjit dhe Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave), dhe
- iii) gjykata kompetente përgjegjëse për shqyrtimin e ankesës.

Këta elementë janë thelbësorë për të garantuar transparencë të plotë në procesin e vendimmarrjes së Komisionit. Përfshirja e tyre gjithashtu do të sigurojë më shumë qartësi për palët e interesuara dhe do të mundësojë ushtrimin efektiv të së drejtës për të apeluar.

Sipas të dhënave zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale rezulton se numri i ankesave për rishikim para Komisioneve të Shqyrtimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror gjatë periudhës së raportimit është mesatarisht rreth 920 ankesa në vit. Për më tepër, sipas të dhënave të Drejtorisë së Ndhmës Ligjore Falas, ekziston një angazhim i qëndrueshëm për ofrimin e shërbimeve ligjore për këtë kategori të cënueshme, si dhe nevoja e vazhdueshme për mbështetje ligjore, si në aspektin e ofrimit të informacionit, ashtu edhe të përfaqësimit ligjor.

**Grafiku 7: Rastet që kanë marrë ndihmë ligjore falas**



Statistikat tregojnë një rënie të lehtë prej 11.9% në numrin e ankesave që morën ndihmë ligjore, si primare ashtu edhe dytësore, nga viti 2024 me 764 raste në vitin 2025 me 673 raste.



**Rekomandim 10:** Të bëhen ndryshime në Formularin e Njoftimit të Vendimit të lëshuar nga Komisionet Multidisiplinare, në mënyrë që të përcaktojnë qartë të drejtën e aplikantit për ankim, bazën ligjore të vendimit dhe autoritetin kompetent ose gjykatën përgjegjëse për shqyrtimin e ankesës. Ky formular i përmirësuar duhet të paraqesë të gjithë informacionin procedural thelbësor në një mënyrë të qartë, të aksesueshme dhe miqësore për përdoruesit, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të kuptojnë plotësisht të drejtat e tyre dhe hapat e mundshëm për të sfiduar një vendim. Ai duhet të specifikojë afatin kohor për dorëzimin e ankesës, organin administrativ që duhet të shqyrtojë fillimisht ankesën dhe autoritetin gjyqësor që ka juridiksion nëse aplikanti kërkon kompensim të mëtejshëm.

**Gjetje 11:** Megjithëse personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për një paketë mbështetëse higjieno-sanitare kanë të drejtë ligjore për një përfitim shtesë financiar, asnjë vendim për përfituesit nuk është lëshuar nga Komisionet Multidisiplinare të Vlerësimit të Aftësive. Kjo ndodh për shkak se legjislacioni dytësor i nevojshëm që përcakton shumën e përfitimit dhe procedurat për zbatimin e tij nuk është miratuar kurrë. Ky mangësim rregullator, që i atribuohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka penguar në mënyrë efektive zbatimin e këtij masi për më shumë se pesë vjet, pavarësisht pranisë së përfituesve të kualifikuar, siç është vënë gjithashtu në dukje nga Avokati i Popullit.

Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e shumës, kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin e aftësive të kufizuara, ndihmës personale dhe strukturave përgjegjëse,” Neni IV, pika 5, parashikon dhënien e një pakete higjieno-sanitare për individët e vlerësuar se kanë nevojë për të. Vendimi përcakton se personat me aftësi të kufizuara që kanë të drejtë për këtë paketë duhet të marrin një pagesë shtesë të ardhurash për të mbuluar kostot e saj, në shumën e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi. Zbatimi i këtij dispozitivi i përket Komisioneve Mjekësore për Vlerësimin e Aftësive në nivelet lokale dhe qendrore. Megjithatë, diskutimet me palët e interesuara tregojnë se asnjë person me aftësi të kufizuara nuk ka përfituar këtë paketë higjieno-sanitare. Pavarësisht dispozitës ligjore dhe udhëzimeve mbi vlerësimin bio-psiko-social, duket se nuk është nxjerrë ndonjë legjislacion dytësor që përcakton shumën e përfitimit. Si rezultat, individët që mund të përmbushnin kriteret e pranueshmërisë nuk kanë pasur mundësi të gëzonin këtë të drejtë. Miratimi i një akti normativ dytësor, potencialisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, do të vendoste detajet dhe kushtet e nevojshme për zbatimin e paketës higjieno-sanitare, duke mundësuar aplikimin praktik të saj sipas VKM Nr. 722.



Ky problem është identifikuar gjithashtu nga Avokati i Popullit, i cili ka kryer një analizë të thelluar të kuadrit ligjor pas shqyrtimit të ankesave konkrete dhe të dokumentuara mirë. Duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes, institucioni ka realizuar një rishikim ligjor të hollësishëm dhe ka nxjerrë rekomandime për zgjidhjen sistematike të problemit, përfshirë:

(i) miratimin e menjëhershëm të masave për nxjerrjen e Udhëzimit për zbatimin e VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, Neni IV, pika 5; dhe

(ii) krijimin e mekanizmave që lejojnë individët me aftësi të kufizuara, të klasifikuar si “në nivel të rëndë” nga Komisionet Multidisiplinare të Vlerësimit të Aftësive, të përfitojnë nga paketa higjieno-sanitare për periudhën para miratimit të aktit normativ dytësor, bazuar në diagnozat e tyre mjekësore, në mënyrë që të njihen dhe të zgjidhen të drejtat e mëparshme që u janë mohuar.

**Rekomandim 11:** Puna jonë mbështet rekomandimet e Avokatit të Popullit, duke njohur rolin thelbësor të tyre në përmirësimin e funksionimit të përgjithshëm të sistemit të vlerësimit të aftësive të kufizuara. Veprimet e mëposhtme forcojnë dhe ndërtojnë mbi ato rekomandime:

- Miratimi i menjëhershëm i masave për nxjerrjen e Udhëzimit për zbatimin e VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, Neni IV, pika 5; dhe

- Miratimi i mekanizmave që lejojnë individët me aftësi të kufizuara, të klasifikuar si “në nivel të rëndë” nga Komisionet Multidisiplinare të Vlerësimit të Aftësive, të përfitojnë nga paketa higjieno-sanitare për periudhën para miratimit të aktit normativ dytësor, bazuar në diagnozat e tyre mjekësore, në mënyrë që të njihen dhe të zgjidhen të drejtat e mëparshme që u janë mohuar.



# Rekomandimet e përgjithshme

Qeveria e Shqipërisë duhet të hartojë një Strategji Kombëtare Afatgjatë për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030, duke përcaktuar veprime konkrete për përmirësimin e jetës së përditshme të të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Kjo strategji duhet të përfshijë angazhime të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, sigurimin e përfshirjes së tyre në proceset e hartimit të politikave dhe ofrimit të shërbimeve, si dhe përcaktimin e veprimeve specifike që çdo ministri ose institucion qeveritar duhet të ndërmarrë për të garantuar zbatimin efektiv të Strategjisë.

- ▶ *Strategjia duhet të artikulojë një vizion afatgjatë qeveritar për të transformuar përvojën e jetës së personave me aftësi të kufizuara, duke adresuar shtyllat kryesore si pabarazitë në arsim, punësim, strehim, transport, shërbime publike dhe jetën qytetare, ndër të tjera.*
- ▶ *Strategjia duhet të formësohet nga shqetësimet dhe perspektivat e personave me aftësi të kufizuara, duke e bërë atë shumë më gjithëpërfshirëse sesa Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025. Duhet të zhvillohet një proces i gjerë dhe kuptimplotë konsultimi dhe dëgjimi, jo i kufizuar vetëm në mendimet e një ose dy organizatave të shoqërisë civile, për të siguruar që Strategjia të përmbajë veprime konkrete që përmirësojnë realisht të gjitha aspektet e jetës së personave me aftësi të kufizuara.*
- ▶ *Për të shmangur që Strategjia të mbetet vetëm në nivel aspiratash, ajo duhet të përfshijë një plan të plotë zbatimi afatgjatë me rezultate të matshme, mekanizma të fortë monitorimi dhe vlerësimi, përfshirje reale të personave me aftësi të kufizuara, financim të mjaftueshëm dhe koordinim të fortë ndër-institucional.*
- ▶ *Strategjia duhet gjithashtu të përfshijë një fushatë ndërgjegjësimit që promovon kuptimin se aftësia e kufizuar është një çështje që i përket të gjithëve dhe që inkurajon ndryshime pozitive në sjelljen individuale. Ajo duhet gjithashtu të përcaktojë se si qeveria do të bashkëpunojë me shoqërinë më të gjerë për të nxitur ndryshime transformuese afatgjata, përfshirë partneritete me bizneset.*
- ▶ *Të vendoset një proces i qartë për monitorimin dhe raportimin vjetor të arritjeve të Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, duke përdorur rezultatet, produktet dhe indikatorët e përcaktuar në Strategji. Të sigurohet që raportet e monitorimit të publikohen rregullisht për të promovuar transparencën dhe për t'u mundësuar organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të kontribuojnë në zbatimin efektiv duke vlerësuar progresin e Strategjisë.*

Gjithashtu, rekomandimet specifike të paraqitura më sipër duhet të trajtohen dhe të përfshihen, sipas rastit, në Strategjinë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.



# Pjesa 2

GJETJE DHE  
REKOMANDIME  
KYÇE FINANCIARE



**Gjetje 1.1.** Financimi dhe Përfituesit: Fondet e shpenzuara për PAK dhe kujdestarët e tyre nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) janë rritur nga 15.86 miliardë lekë në 2019 në 19.6 miliardë lekë në 2024. Megjithatë, numri i përfituesve ka shënuar një rënie (me rreth 2,864 individë), duke ngritur pikëpyetje mbi efikasitetin e shpenzimeve. Pagesat direkte për PAK variojnë nga 10% deri në 21% të pagës mesatare dhe janë dukshëm më të ulëta se në vende të ngjashme të BE-së.

**Gjetje 1.2.** Kjo reformë, e implementuar plotësisht në janar 2023, synonte uljen e rasteve abuzive me 10% dhe reduktimin e shpenzimeve me 27% deri në 2024. Edhe pse ka një rënie të numrit të përfituesve, fondet totale janë rritur dhe mungojnë tregues të qartë të performancës për matjen e rasteve abuzive, duke bërë të paqartë përmbushjen e plotë të objektivave.

**Gjetje 1.3.** Ka mungesë udhëzimesh dhe zbatim të fragmentuar të fondeve sociale në nivel bashkie. Shumë bashki nuk i kanë ngritur ose i financojnë shërbimet përmes programeve buxhetore ekzistuese, jo fondeve të dedikuara.

**Rekomandim 1.1.** Rekomandohet rritja progresive dhe e qëndrueshme e financimit për personat me aftësi të kufizuara nga buxheti i shtetit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe garantimin e ushtrimit të plotë të të drejtave themelore. Rritja e financimit duhet të fokusohet jo vetëm në pagesat direkt, por në zgjerimin dhe forcimin e shërbimeve sociale komunitare, mbështetjen për jetesë të pavarur, si dhe në ofrimin e shërbimeve të integruara sociale dhe shëndetësore. Në këtë kuadër, është e nevojshme që planifikimi buxhetor të bazohet në nevoja reale, analiza të kostos së shërbimeve dhe monitorim të vazhdueshëm të ndikimit të shpenzimeve publike.

**Rekomandim 1.2.** Të vendosen standarde të qarta dhe të detyrueshme për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave të disagreguara (për kategori aftësie, gjeografi, moshë, gjini) nga të gjitha ministritë dhe institucionet përgjegjëse. Të fokusohet monitorimi në treguesit e performancës dhe rezultatet konkrete të arritura, jo vetëm në shpenzimet e fondeve.

**Rekomandim 1.3.** Të krijohen mekanizma më të fortë koordinimi ndërmjet ministrive dhe njësive të qeverisjes vendore për të siguruar një qasje holistike dhe të integruar në ofrimin e shërbimeve dhe zbatimin e politikave për PAK.

# Punësim dhe aftësim profesional



**Gjetje 2.** Pavarësisht legjislacionit që detyron punëdhënësit të punësojnë PAK dhe ekzistencës së Fondit Social të Punësimin, zbatimi i politikave ka qenë minimal dhe joefektiv. Numri i PAK të papunë të regjistruar është ulur ndjeshëm nga 542 në 2019 në 237 në 2022. Numri i PAK të punësuar ka rënë në mënyrë drastike nga 82 në 2019 në vetëm 18 në 2022. Fondet e buxhetit të shtetit për programet e nxitjes së punësimin për PAK përbëjnë vetëm 1% të shpenzimeve totale, një trend konstant. Zbatimi i politikës së ndërmarrjeve sociale ka nisur me vonësë dhe me rezultate minimale.

**Rekomandim 2.** Të garantohet ngritja dhe funksionimi i duhur i fondeve sociale në çdo bashki, me udhëzime të qarta dhe kapacitete të forta administrative. Të analizohen shkaqet e dështimit të politikave të punësimin për PAK dhe të zhvillohen programe më të targetuara, me financim të duhur dhe me mekanizma monitorimi të fortë.



## Arsimi

**Gjetje 3.** Numri i mësuesve ndihmës është rritur ndjeshëm nga 620 në 2019 në 2,167 në 2024, me shpenzime të vlerësuara prej 2.34 miliardë lekë në 2024. Ka të dhëna kontradiktore dhe një rënie të ndjeshme të numrit të nxënësve në qendrat burimore (nga 700 në 2019 në 160 në 2024), ndërkohë që shpenzimet për ta janë rritur. Mungon analiza e performancës së këtyre qendrave. Të dhënat nga Ministria e Arsimit janë të pjesshme, të paqarta dhe kontradiktore, veçanërisht për bursa apo tekste shkollore falas dhe investimet në aksesueshmërinë shkollore.

**Rekomandim 3.** Të zgjidhen mospërputhjet në të dhënat për nxënësit me AK dhe të sigurohet një sistem i qëndrueshëm dhe transparent për monitorimin e tyre. Të investohet në infrastrukturën shkollore për të garantuar aksesueshmërinë dhe në burime të dedikuara për zhvillimin e mësuesve ndihmës dhe specialistëve të tjerë.



**Gjetje 4.** Aksesueshmëria është një objektivi i rëndësishëm i PKPAK (19% e kostos totale), por zbatimi është i pjesshëm dhe i fragmentuar. Mungon transparenca dhe llogaridhënia nga ana e ministrisë përgjegjëse për transportin lidhur me zbatimin e këtij objektivi. Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit konkludon se kuadri ligjor nuk po implementohet si duhet. Bashkitë nuk kanë plane specifike apo monitorim sistematik dhe legjislacioni nuk është i harmonizuar me standardet e BE-së. Për sa i përket aksesueshmërisë në informacion (p.sh., platforma e-Albania), masat janë planifikuar për vitin 2026 dhe deri tani nuk është realizuar asnjë masë konkrete.

**Rekomandim 4.** Të hartohen dhe zbatohen plane specifike dhe afate të qarta për aksesueshmërinë fizike në infrastrukturën publike dhe transportin rrugor, duke siguruar harmonizimin me standardet e BE-së. Të përshpejtohet implementimi i aksesueshmërisë digjitale për platformat e-Albania dhe faqet e internetit të institucioneve publike, duke siguruar që këto masa të jenë operative shumë më herët se viti 2026.



e-albania

# ANALIZA FINANCIARE



Kjo analizë mbështet përfundimet dhe rekomandimet e përshkruara më sipër.

## **Analizë e shpenzimeve të kryera nga buxheti i shtetit për Personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë**

Në këtë kapitull do të analizojmë fondet e shpenzuara nga buxheti i shtetit për të përmbushur detyrimet e parashikuara nga legjislacioni aktual për personat me aftësi të kufizuara përgjatë periudhës 2019-2024. Të dhënat e përdorura i referohen Programeve Buxhetore Afatmesme të periudhave 2019-2024 dhe raporteve të monitorimit të publikuara nga Ministritë përgjegjëse të fushës. Në disa raste hulumtimi është bërë dhe në raporte periodike të monitorimit të punës të institucioneve publike për të gjetur të dhëna mbi rezultatet e arritura.

Dokumenti bazë mbi të cilin mbështetet monitorimi i shpenzimeve buxhetore është Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2021-2025, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.279, datë 12.5.2021. Plani është hartuar duke ndjekur standartin e planifikimit dhe monitorimit buxhetor duke disagreguar qëllimet e politikave në fusha të ndryshme, në objektiva specifike dhe masa konkrete për realizimin e tyre.

Gjurmimi i të dhënave financiare është bërë duke ju referuar të dhënave në raportet e monitorimit vjetor të publikuara në Ministrië e Linjës për çdo vit të periudhës 2019-2024 në nivel produkti/projekti dhe treguesve të performancës duke u përpjekur të analizojë të dhënat dhe në terma përfituesish dhe rezultatesh të arritura. Duke qënë se informacioni i nevojshëm për të realizuar një monitorim sa më të plotë të shpenzimeve është specifik i jemi drejtuar institucioneve përgjegjëse dhe në formë shkresore për të mundësuar plotësimin e kuadrit të analizës. Të dhënat e përcjella prej tyre janë përfshirë si pjesë e kësaj analize.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me aftësi të kufizuara 2021-2025 ka një qasje ndërsektoriale duke vendosur objektiva dhe masa në shumë fusha të politikave rezultatet e të cilave ndikojnë jetesën e përditshme të personave me aftësi të kufizuar. Ai synon të përmirësojë integrimin social dhe ekonomik të kësaj kategorie përmes politikave të strukturuar në tetë fusha kryesore: 1) aksesueshmëria, 2) drejtësia, 3) punësimi, 4) arsimiti, 5) shëndetësia, 6) përfshirja sociale, 7) pjesëmarrja në jetën publike dhe 8) politike.

Sipas PKPAK 2021 – 2025, buxheti i parashikuar është përlllogaritur në 1,466,608,650 lekë (rreth 11.8 milionë euro). Financimi është planifikuar të mbulohet nga buxheti i shtetit në masën 75%, nga kontributet e donatorëve dhe burime të tjera në masën 7%, ndërsa mbetet një hendek financiar prej 18%. Shpërndarja e buxhetit të parashikuar sipas objektivave kryesorë është si vijon:



**Tabela 4:** Kostoja e Qëllimeve të Planit të veprimit të PAK

Qëllimet e Politikave të Planit të Veprimit	Kostoja Totale 2021-2025 në leke	Pesha ndaj totalit
<b>Qëllimi 1:</b> Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise, shërbime, transport dhe informacion	289,475,204	19.7%
<b>Qëllimi 2:</b> Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë	214,084,632	14.6%
<b>Qëllimi 3:</b> Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë	135,445,952	9.2%
<b>Qëllimi 4:</b> Sigurimi dhe ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor	218,406,474	14.9%
<b>Qëllimi 5:</b> Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme	119,414,160	8.1%
<b>Qëllimi 6:</b> Ofrimi i një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm e të përballueshëm	359,452,088	24.5%
<b>Qëllimi 7:</b> Garantimi i përfshirjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike në Shqipëri dhe mundësimi i mbrojtjes së interesave të tyre	83,866,868	5.7%
<b>Qëllimi 8:</b> Krijimi i sinergjive ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm për nxitjen dhe monitorimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë të plotë, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme	46,463,272	3.2%
<b>TOTALI</b>	<b>1,466,608,650</b>	<b>100.0%</b>

*Burimi: Plani i Veprimit PAK 2021-2025*

Nga analiza e realizuar në raport po paraqesim të përmbledhura fondet buxhetore të shpenzuara për politikën që kemi mundur të identifikojmë në raportet e monitorimit apo analizat vjetore të punës të institucioneve përgjegjëse për personat me aftësi të kufizuara. Theksojmë që informacioni financiar i analizuar në këtë raport për shkak të kufizimeve nuk mund të lidhet me atë të planifikuar me Planin e Veprimit të PAK për periudhën 2021-2025, duke rezultuar e vështirë lidhja e fondeve të shpenzuara nga buxheti i shtetit me masat e planifikuara në të.



**Tabela 5:** Fondet e shpenzuara nga buxheti i shtetit për periudhën 2019-2024 për kategorinë PAK

Fushat e politikave	Shpenzimet nga buxheti 2019-2024 ne leke	Pesha ndaj totalit
<b>Fusha 1: Përkujdesi Social</b>	112,776,114,525	94.6%
<b>Fusha 2: Arsimi*</b>	6,342,119,176	5.3%
<b>Fusha 3: Punësimi dhe Aftësimi Profesional</b>	36,493,454	0.0%
<b>TOTALI</b>	<b>119,154,727,155</b>	<b>100.0%</b>
<b>Buxheti I Shtetit Faktik 2019-2024</b>	<b>3,678,899,350,000</b>	<b>3.2%</b>

*Burimi: Ministria e Financave, buxheti faktik në vite*

\* Shpenzimet e përlogaritura për fushën e arsimit kanë të përfshira kostot totale që shpenzon buxheti i shtetit për tekstet falas dhe fëmijët në nevojë. Në mungesë të statistikave të sakta e kemi të pamundur të nxjerrim përpjesën e fondeve që i takojnë kategorisë PAK.

Sikurse shihet peshën më të lartë të fondeve të shpenzuara nga buxheti i shtetit për kategorinë e personave e zë fusha e përkujdesit social, e konkretisht pagesat direkte që shkojnë për këtë kategori dhe kujdestarët e tyre. Sa i përket politikave të tjera si arsimit, punësimi dhe formimi profesional shpenzimet rezultojnë të vogla ose të papërfillshme duke dëshmuar që financim i politikave të tjera të lidhura me ofrimin e shërbimeve alternative apo programeve riintegruese për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara është minimal.

Thëksojmë që në analizë nuk janë përfshirë shpenzimet e kryera nga buxheti i shtetit për investime publike pasi referuar të dhënave të publikuara në raportet e monitorimit të buxhetit të ministrive të linjës nuk arrijmë të identifikojmë projekte të lidhura drejtpërdrejtë me personat me aftësi të kufizuara.

Nëse analizojmë përpjesën që zënë këto shpenzime ndaj totalit të buxhetit të shtetit faktik të shpenzuar përgjatë periudhës 2019-2024, ato përbëjnë vetëm 3.2% ndaj totalit.

Më poshtë gjendet analiza e detajuar në terma përfituesish dhe financiare e fokusuar në fushën e përkujdesit social, arsimit, punësimit dhe formimit profesional, fusha në të cilat arritëm të identifikojmë informacione. Hulumtimet tona u ndalën dhe në fusha të tjera si aksesueshmërisë në mjedise, transport dhe informacion për të cilat kemi përgatitur një narrativë të informacioneve të gjetura.



## 6. Shpenzimet nga buxheti i shtetit për PAK në fushën e përkujdesit Social

Në fushën e përkujdesit social, qëllimi kryesor i planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara është “Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin”. Objektivat dhe masat e parashikuara nën këtë qëllim synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes sociale për personat me aftësi të kufizuara, duke u mbështetur në modelin e të drejtave të njeriut dhe parimet e jetesës së pavarur. Një vëmendje e veçantë i kushtohet monitorimit të efekteve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga modeli i ri bio-psiko-social, për të garantuar respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të këtyre personave. Paralelisht, fokusi është në ofrimin e shërbimeve të integruara sociale, përmes kombinimit të mbështetjes financiare me shërbime cilësore të kujdesit social, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së mbështetjes. Përmes zhvillimit të shërbimeve të reja sociale komunitare promovohet jetesa e pavarur dhe përfshirja aktive e personave me aftësi të kufizuara në komunitet, duke reduktuar varësinë nga institucionalizimi. Nisur nga sa më sipër, analizuam raportet e monitorimit të ministrisë përgjegjëse për përkujdesin social si dhe dokumentat buxhetorë afatmesëm të publikuar për periudhat 2025-2027 dhe 2026-2028. Buxheti i alokuar në vite dhe numri i përfituesve PAK dhe kujdestarëve të tyre paraqitet si më poshtë vijon:

**Tabela 6:** Numri i përfituesve PAK dhe kujdestarëve dhe fondet buxhetore 2019-2028

Viti	Ministria	Programi Buxhetor	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Buxheti	Sasia	Shpenzime Buxhetore
2019	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani fillestar	163,000	15,850,000,000
2019	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani i rishikuar	163,000	15,884,500,000
2019	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Fakti	166,968	15,860,125,268
2020	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani fillestar	165,000	16,405,000,000
2020	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani i rishikuar	165,000	18,621,593,001
2020	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Fakti	169,530	18,465,130,056
2021	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani fillestar	172,410	18,745,540,000
2021	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani i rishikuar	0	17,273,540,000
2021	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Fakti	162,581	17,079,189,261
2022	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani fillestar	167,000	16,990,000,000
2022	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani i rishikuar	167,000	18,535,928,000
2022	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Fakti	161,683	18,429,006,477
2023	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani fillestar	160,000	17,736,000,000
2023	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani i rishikuar	160,000	18,568,258,000
2023	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Fakti	163,298	18,349,195,850
2024	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani fillestar	161,000	17,918,000,000
2024	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plani i rishikuar	161,000	19,735,492,000
2024	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Fakti	164,104	19,612,354,218
2025	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plan fillestar	92,000	15,238,000,000
2026	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plan fillestar	94,000	15,268,000,000
2027	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plan fillestar	95,000	15,712,000,000
2028	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AB	PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa	Plan fillestar	98,000	15,882,000,000

Burimi: Raportet e Monitorimit të Buxhetit 2019-2024 MSHMS dhe Dokumentat e PBA 2025-2028


Fondet e shpenzuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të cilat shkojnë si pagesa direkte për personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre rezultojnë në rritje nga viti 2019 e deri në vitin 2024. Konkretisht, në vitin 2019 kanë përfituar mbështetje financiare rreth 166 968 PAK dhe ndihmësit e tyre me një fond total prej 15.86 miliardë lekë. Ndërkohë që në vitin 2024, numri i përfituesve reduktohet me 2 864 krahasuar me 2019 ndërsa fondi i alokuar si mbështetje buxhetore rezulton i rritur në masën 19.6 miliardë lekë. Në planifikimin buxhetor afatmesëm të bërë nga MSHMS për periudhën 2025-2028 vihet re që numri i përfituesve dhe fondi përkatës rezulton i reduktuar. Ky reduktim vjen si rezultat i kalimit të fondit të pagesave për kategorinë e invalidëve të punës tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në kuadër të lehtësimit të kësaj kategorie për marrjen e të gjitha përfitimeve të invaliditetit në një sportel. Referuar raporteve të monitorimit të publikuara nga MSHMS mungojnë të dhëna të detajuara të disagreguara më vete për personat me aftësi të kufizuara dhe më vete për ndihmësit e tyre. Gjithashtu nuk rezultojnë të ketë statistika të publikuara në këto raporte lidhur me ndarjen sipas kategorive të përfituesve. Pavarësisht se në këto raporte mungojnë të dhëna, Instituti i Statistikave i mbështetur nga Shërbimi Social Shtetëror ka të publikuar të dhëna të detajuara të përfituesve sipas kategorive të cilat po i paraqesim më poshtë:

**Tabela 7:** Numri mesatar i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë pagesë paaftësie dhe shërbim kujdestarie, 2019-2023

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022	2023
<b>Gjithsej invalidë</b>	<b>71,032</b>	<b>73,718</b>	<b>71,281</b>	<b>70,208</b>	<b>72,474</b>
Sipas kategorive:					
Të verbër	12,399	12,414	12,143	12,445	12,982
Para-tetraplegjik	6,666	6,641	6,244	5,973	5,857
Paaftësi mendore e fizike	51,967	54,663	52,894	51,790	53,635
<b>Shërbime kujdestarie</b>	<b>19,650</b>	<b>19,790</b>	<b>18,725</b>	<b>18,119</b>	<b>18,340</b>
<b>Invalidë pune</b>	<b>74,551</b>	<b>74,734</b>	<b>73,347</b>	<b>72,790</b>	<b>72,484</b>
<b>Përfitues gjithsej</b>	<b>165,233</b>	<b>168,242</b>	<b>163,353</b>	<b>161,117</b>	<b>163,298</b>

Burimi: Shërbimi Social Shtetëror dhe INSTAT

**Grafiku 8:** Përpjesa e përfituesve sipas kategorisë së paaftësisë





Sikurse shihet nga tabela dhe nga grafiku, numri i kujdestarëve/ndihmësve për personat me aftësi të kufizuara qëndron në nivele konstate përgjatë periudhës 2019-2024 duke përbërë mesatarisht 11% të totalit të numri të përgjithshëm. Ndërkohë që dhe përpjesa e invalidëve të punës me kategoritë e tjera të invaliditetit të lidhura me paftësitë mendore ose fizike qëndron në nivelin prej 44%. Në vitin 2021 vihet re që numri i përfituesve reduktohet krahasuar me përfituesit në vitet 2019-2020. Reduktimi rezulton me rreth 4 889 dhe vijon të mbetet në këto nivele dhe përgjatë periudhës 2022-2024. Vlerësojmë se ndryshimi i atribuohet iniciativave të ndërmarra nga MSHMS për reformimin e procesit të lidhur me vlerësimin e paftësisë së kufizuar si dhe, iniciativës për deinstitutionalizim dhe përfshirje të shërbimeve sociale. Pavarësisht konkluzioneve të arritura nga analizimi i numrit të përfituesve theksojmë që në raportet e monitorimit të MSHMS nuk gjejmë analiza apo informacione të detajuara mbi progresin e bërë deri në fund të vitit 2024 mbi reformën e vlerësimit bio-psiko-social të pilotuar në qytetin e Tiranës, shtrirjen e tij në të gjithë Shqipërinë dhe rezultatet e arritura sipas planeve të punës.

Sipas të dhënave të kufizuara të publikuara në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror, vlerësimi Bio-Psiko-Social në Shqipëri ka nisur pilotimin në vitin 2017 në dy njësi administrative në Qarkun Tiranë, nr. 6 dhe nr. 7. Reformimi është realizuar me mbështjen e projektit të Bankës Botërore “Modernizimi i Asistencës Sociale në Shqipëri”. Në vitin 2019 ky model vlerësimi u shtri në të gjithë njësitë administrative të Qarkut Tiranë dhe në fund të vitit 2021 në Qarkun Durrës dhe Elbasan. Reformimi i skemës së aftësisë së kufizuar ka përfunduar në Janar 2023, duke u shtrirë në të gjithë Shqipërinë. Në përfundim të reformës janë ngritur 37 komisione të vlerësimit shumëdisiplinore në nivele qarku dhe 3 Komisione për Shqyrtimin e Ankesave, të cilët shqyrtojnë ankesat e qytetarëve për vendimet e marra nga KVSHAK në nivel qarku.<sup>13</sup> Në Qershor të vitit 2019, MSHMS miratoi me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.380, datë 5.6.2019, dokumentin politik “Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019–2024 për zbatimin e tij”. Ky dokument formalizoi reformën e vlerësimit bio-psiko-social e cila synonte të kombinonte pagesat në para me shërbime sociale. Objektivi kryesor i skemës ishte realizimi i vlerësimit bio-psiko-social duke ulur me 10% rastet abuzive të përfituesve që nuk shfaqin aftësi të kufizuar deri në vitin 2020, dhe duke reduktuar fondin që shkon për përfitimet në pagesa në masën 27% deri në vitin 2024.

Për të analizuar nëse reforma e vlerësimit bio psiko social e ka përmbushur objektivin e saj kryesor kërkua në raportet e monitorimit të buxhetit për rezultatet e programit buxhetor të përkujdesit social por nuk gjetëm tregues performance të cilat masin reduktimin e rasteve abuzive. Pavarësisht kësaj referuar statistikave të përfituesve të cilat rezultojnë në rënie krahasuar me periudhën 2019, me gati 3% ndaj totalit të vitit 2023 vlerësojmë se objektivi për të reduktuar rastet abuzive është realizuar pjesërisht.

[13] <https://www.sherbimisocial.gov.al/rreth-vleresimit-bio-psiko-social/>



Gjithsesi ky përfundim duhet vlerësuar me kujdes, pasi mbetet e paqartë se mbi ç'bazë është llogaritur synimi 10% e konkretisht mbi numrin total të përfituesve apo mbi numrin e praktikave abuzuese të modelit të mëparshëm të vlerësimit. Sa i përket reduktimit të fondit të përfitimit në pagesa në masën 27%, referuar të dhënave të publikuara konkludojmë që fondi total është rritur nga 15.86 miliardë lekë në vitin 2019 në 19.6 miliardë lekë në vitin 2024. Kjo rritje i dedikohet dhe rritjes së masës së pensionit social nga viti 2019 në vitin 2024, pasi referuar legjislacionit dytësor që rregullon masën e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar<sup>14</sup>, pagesa referencon tek pensioni social. Realizimi i treguesit të reduktimit të fondit të përfitimit duhet analizuar rast pas rasti pasi dhe përfitimet nga pagesa e paftësisë së kufizuar dhe paketat shoqëruese si kompensimi i energjisë apo paketa higjeno- sanitare janë të ndryshme në varësi vlerësimit të personit. Të dhënat e publikuara nga Shërbimi Social Shtetëror janë të kufizuara duke vështirësuar analizën e masës së përfitimit për të bërë të mundur dhe një krahasim se si ka evoluar ajo sipas modelit të ri. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar për të rritur dhe fëmijë është 150% e shumës së pensionit social, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kështu nëse në vitin 2024 masa e pensioni social sipas ISSH rezultonte 9710 lekë në muaj, pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar përlllogaritej në 14 565 lekë në muaj. Kjo pagesë sipas modelit të ri të vlerësimit varion si më poshtë vijon:

- a) *personat mbi 18 vjeç me kufizime të lehta referohen për të përfituar shërbime/punësim ose, në mungesë të tyre, përfitojnë 60% të pagesës bazë ose 8 739 lekë në muaj;*
- b) *personat mbi 18 vjeç me kufizime mesatare përfitojnë 80% të pagesës bazë ose 11 652 lekë në muaj;*
- c) *personat mbi 18 vjeç me kufizime të rënda përfitojnë 100% të pagesës bazë;*
- d) *personat mbi 18 vjeç me kufizime të thella përfitojnë 120% të pagesës bazë ose 17 478 lekë në muaj;*
- e) *fëmijët me kufizime të lehta referohen për të përfituar shërbime ose në mungesë të tyre përfitojnë 75% të shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime të lehta, të përcaktuar në shkronjën “a” ose rreth 6 554 lekë në muaj;*
- f) *fëmijët me kufizime mesatare përfitojnë 75% të shumës së përcaktuar për personat madhorë me kufizime mesatare, të përcaktuar në shkronjën “b” ose rreth 8 739 lekë në muaj;*
- g) *fëmijët me kufizime të rënda përfitojnë 75% të shumës që përfitojnë personat madhorë me kufizime të rënda, të përcaktuar në shkronjën “c” ose rreth 10 924 lekë në muaj;*
- h) *fëmijët me kufizime të thella përfitojnë 75% të shumës që përfitojnë personat madhorë me kufizime të thella, të përcaktuar në shkronjën “ç” ose rreth 13 108 lekë në muaj.*

[14] VKM nr.772/2019 i ndryshuar “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”



Krahas përfitimeve të pagesës bazë, në bazë të vlerësimit të bërë nga komisioni shumëdisiplinor mund të merren dhe paketa shtesë si më poshtë vijon:

a) Fëmijët e moshës mbi 3 vjeç dhe të rriturit, të cilët janë vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare në rastet kur kanë dëmtime të rënda ose të thella të lëvizshmërisë dhe që shfaqin mungesë vetëpërmbajtjeje urinare apo defekimi, do të pajisen me një paketë higjieno-sanitar. Vlera e paketës higjieno sanitare për vitin 2024 ka qënë 20 000 lekë në muaj dhe është miratuar me VKM nr.744/2024. Kjo paketë indeksohet çdo vit mbështetur në indeksin e çmimit të konsumit.

b) Fëmijët e moshës mbi 3 vjeç dhe të rriturit, të cilët janë vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit se kanë nevojë për karrige me rrota në rastet kur kanë dëmtime të rënda ose të thella të lëvizshmërisë, mund të pajisen me karrige me rrota, të cilat administrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, përmes rrjetit farmaceutik. Nga analiza e akteve nënligjore nuk rezulton të ketë një cmim mesatar të paracaktuar për rimbursimin e karrocave. Si rezultat, referuar praktikave ndërkombëtare cmimi mesatar i një karroce me rrota luhetet nga 450 dollarë në rreth 1200 dollarë.<sup>15</sup>

c) Fëmijët e moshës mbi 3 vjeç dhe të rriturit, të cilët janë vlerësuar nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit se kanë vështirësi në komunikim, mund të pajisen me pajisje të teknologjisë mbështetëse për komunikim, të cilat administrohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, përmes rrjetit farmaceutik.

d) Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm, të lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 150% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi. Në rastet kur janë anëtarë të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike përfitojnë pagesë, në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi.

Ndërsa, sa i përket pagesës së kujdestarit/ndihmësit personal rastet janë të paraqitura si më poshtë vijon:

- *Shuma e pagesës për shërbime gjithëpërfshirëse është 120% e pagesës bazë të aftësisë së*
- *Kufizuar ose 17 478 lekë në muaj në vitin 2024;*
- *Shuma e pagesës për shërbime të herëpashershme është 80% e pagesës bazë të aftësisë së*
- *Kufizuar ose 11 652 lekë në muaj në vitin 2024.*

[15] <https://www.ahealthcare.com/eurochair-2-pro-manual-wheelchair-en>; kostot e vendosura janë informacione të përgjithshme nga ofrues të pajisjeve mjekësore dhe tregtarë online të kujdesit shëndetësor (si furnizuesit e karrigeve me rrota dhe pajisjeve ortopedike), përfshirë dhënien e kostove mesatare për këto pajisje në tregjet evropiane dhe atë lokal. (p.sh., furnitorë të pajisjeve mjekësore në BE; çmime tregtare). Këto çmime janë orientuese dhe nuk përfaqësojnë tarifa të vendosura nga shteti për rimbursim, por shërbejnë për të kuptuar koston mesatare të pajisjeve në treg.



- Ndhmësit personalë, që ofrojnë shërbime të ndihmësit personal për më shumë se një përfitues, marrin një shtesë prej 50% të shumave përkatëse për çdo përfitues të shtuar.

Së fundi, legjislacioni dytësor<sup>16</sup> që rregullon procedurat dhe masat e pagesës së aftësisë së kufizuar ka parashikuar të drejtën për të përfutuar shërbime të përkthimit të gjuhës së shenjave për:

1. *personat që kanë 100% humbje të dëgjimit, të provuar me dokumente shoqëruese mjekësore;*
2. *personat që përdorin gjuhën e shenjave në komunikimin e përditshëm, të verifikuar gjatë intervistës me komisionin shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;*

Nëse do të bëjmë një monetarizim të përfitimeve mesatare për një person me aftësi të kufizuar në Shqipëri të lidhur me pagesat direkte do të konkludojmë se pagesat variojnë nga minimalisht 8 739 lekë në muaj për personat të rritur me kufizime të lehta në maksimalisht 17 478 lekë për persona të rritur me kufizime të rënda. Ndërkohë që po të përfshijmë dhe pagesën e ndihmësit personal që ofron shërbime gjithëpërfshirëse dhe paketa higjeno-sanitare këto pagesa shkojnë në 54 956 lekë në muaj.

Në vlerësimet monetare nuk është përfshirë sigurime i pajisjeve ndihmëse si karroca me rrota apo pajisje të tjera për lehtësimin e lëvizjeve për të cilat nuk disponojmë vlera konkrete. Theksojmë që këto shpenzime nuk janë me baza me mujore dhe kanë më tepër natyrë të përhershme e kryhen me një periodicitet më të gjatë se një vit.

Po të krahasojmë përfitimet e personave me aftësi të kufizuara me pagën mesatare në Shqipëri për vitin 2024 e cila rezultonte në masën 83 401 lekë në muaj<sup>17</sup>, ato varionin nga 10%-21% të totalit.

Krahasuar me pagën minimale të vitit 2024 prej 40 000 lekë në muaj përpjesa e pagesave direkte që merrte një person me aftësi të kufizuar përbënte 22%-44% të kësaj page. Krahasuar me vendet me të ardhurat të larta të Bashkimit Europian si Austria, Belgjika dhe Holanda mund të themi që pagesat direkte në para variojnë nga 30-40% të medianës së pagës mesatare të këtyre vendeve<sup>18</sup> duke rezultuar kështu minimalisht dyfish më të larta se ato të vendit tonë.

[16] VKM 431/2016 e ndryshuar “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”

[17] <https://www.instat.gov.al/sq/temat/tregu-i-punes-dhe-arsimi/pagat/#tab2>

[18] [https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2022/10/disability-ëork-and-inclusion\\_db6df91a/1eaa5e9c-en.pdf](https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2022/10/disability-ëork-and-inclusion_db6df91a/1eaa5e9c-en.pdf)



Reforma e nisur në fushën e asistencës sociale synonte krahas ristrukturimit të pagesave në cash dhe shtimin e shërbimeve të integruara për persona me aftësi të kufizuar në Republikën e Shqipërisë. Rrjeti i shërbimeve psiko-sociale aftësuese e riaftësuese është ende i pazhvilluar në shkallë kombëtare. Aktualisht, ai mbulon pjesë të vetëm disa terriore gjeografike, kryesisht urbane, dhe disa grupe të aftësisë së kufizuar.<sup>19</sup>

Për të arritur këtë qëllim Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratoi ligjin nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Financimi i parashikimeve të bëra në këtë ligj bëhet përmes buxhetit qendror, buxhetit të bashkive (njësive të vetëqeverisjes vendore) përfshirë këtu dhe fondin social. Sipas ligjit të sipërcituar, Bashkia, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, krijon dhe administron fondin social, nëpërmjet të cilit sigurohet mbështetje financiare për njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale.

Referuar raporteve të monitorimit të buxhetit të MSHMS, për periudhën 2020-2024 dhe programeve buxhetore afatmesme për periudhat 2025-2027 dhe 2026-2028 në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet e kryera nga buxheti qendror për shërbimet e integruara. Këto fonde përbëjnë pjesën e fondeve që transferohen nga buxheti qendror tek Njësitë e Vetëqeverisjes vendore për këtë qëllim.

Krahas kësaj në zbatim të VKM nr.822/2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, personat që marrin shërbime në qendrat e zhvillimit marrin 1 000 (një mijë) lekë në muaj për rimbursimin e shpenzimeve të tyre personale.

---

[19] Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2025, faqe 18



**Tabela 8:** Numri i shërbimeve të integruara dhe fondet buxhetore të shpenzuara për periudhën 2020-2024

Viti	Ministria	Programi Buxhetor	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Buxheti	Sasia	Shpenzime Buxhetore
2020	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani fillestar	0	70,000,000
2020	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani i rishikuar	0	135,908,901
2020	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Fakti	14	94,481,128
2021	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani fillestar	20	200,000,000
2021	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani i rishikuar	20	185,030,000
2021	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Fakti	55	147,894,616
2022	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani fillestar	35	200,000,000
2022	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani i rishikuar	35	195,368,000
2022	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Fakti	35	158,818,000
2023	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani fillestar	45	300,000,000
2023	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani i rishikuar	45	199,077,000
2023	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Fakti	49	176,293,132
2024	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani fillestar	49	320,000,000
2024	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plani i rishikuar	49	324,042,144
2024	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Fakti	54	275,365,973
2025	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plan fillestar	80	330,000,000
2026	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plan fillestar	95	400,000,000
2027	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plan fillestar	105	430,000,000
2028	MSHMS	Përkujdesja Sociale	91307AH	Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social	Plan fillestar	115	450,000,000

*Burimi: Raportet e monitorimit të MSHMS 2020-2024 dhe dokumentat e PBA 2025-2028*

Sikurse shihet financimi i shërbimeve sociale për grupet në nevojë ka nisur në vitin 2020 me një fond total të planifikuar prej 70 milionë lekë, i cili është rishikuar në rritje gjatë këtij viti duke rezultuar 135.9 milionë lekë. Shpenzimet faktike të kryera në këtë vit rezultojnë 94 milionë lekë. Pozitiv rezulton fakti që fondi i alokuar për mbështetjen e këtyre shërbimeve rezulton në rritje nga viti 2020 nga 94 milionë të shpenzuara faktikisht në 275 milionë lekë të shpenzuara në fund të vitit 2024. Trendi i planifikimit vijon të jetë në rritje dhe periudhën 2025-2028 duke kulmuar në 450 milionë lekë të parashikuara për vitin 2028. Numri i shërbimeve në vitin 2021 ka qënë 55, për të vazhduar në 35 shërbime të reja në vitin 2022, 49 shërbime të financuara në 2023 dhe 54 në vitin 2024.



Në vitet 2025-2028 numri i shërbimeve parashikohet të shtohet nga 80 në 115 shërbimet të reja. Sa i përket llojeve të shërbimeve dhe shpërndarjes së tyre sipas bashkive në raportin e monitorimit për vitin 2020 e në vijim dhe në dokumentat e PBA respektive nuk paraqiten detaje për të kuptuar më tepër mbi natyrën e tyre dhe adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara nga këto shërbime.

Ndërkohë nuk disponojmë informacion të detajuar mbi fondin social të krijuar në çdo bashki nga burime të tjera si dhe nuk disponojmë informacion mbi fondet që alokojnë vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore nga buxheti i tyre për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara për shërbime sociale. Në analizën e kryer nga UNDP të publikuar në Janar të vitit 2023 mbi “Kuadrin ligjor dhe sfidat e fondit social” citohet “Mungesa e udhëzimeve specifike për ngritjen dhe administrimin e fondit social në nivel bashkie ka rezultuar në perceptime dhe realitete të ndryshme mbi konceptin dhe funksionimin e fondit social në bashki të ndryshme.

Kështu, mbi 1/4 e bashkive të kontaktuara raportuan se ato nuk e kanë të ngritur fondin social sipas përcaktimit të Nenit 47/1 të ligjit Nr. 121/2016, duke treguar se mungesa e buxhetit përkatës si dhe kapaciteteve apo infrastrukturës kanë qenë shkaqe që kanë ndikuar në këtë drejtim. Nga ana tjetër, edhe në bashkitë që treguan se e kanë të ngritur fondin social sipas përcaktimit të Nenit 47/1 të ligjit Nr. 121/2016 (71 përqind e bashkive të kontaktuara), diskutimet treguan se në realitet fondi social nuk ekziston si një fond i posacëm buxhetor, por financimi përmes fondeve të financimit të shërbimeve sociale kryhet sipas programeve buxhetore ekzistuese për shërbimet sociale. Kështu, vetëm 15 përqind e bashkive të kontaktuara treguan se financimi për përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, krijimin e shërbimeve të reja, si dhe për zhvillimin e politikave sociale kryhet përmes fondit social, ndërkohë që 38 përqind e bashkive treguan se këto funksione kryhen përmes programeve buxhetore për financimin e këtyre shërbimeve dhe 33 përqind, përmes kombinimit të të dy formave”.<sup>20</sup>

Në analizën vjetore të punës për vitin 2023 të publikuar nga Shërbimi Social Shtetëror, raportohen 46 qendra/projekte të përkujdesit shoqëror, të cilat janë mbështetur me Fond Social për vitin 2023. Sipas Shërbimit Social Shtetëror, problematikat me fondin social në bashki lidhen me mungesën e stafit të trajnuar dhe faktin se shumë shërbime të ngritura nga bashkitë nuk kanë kritere të miratuara nga Këshilli Bashkiak dhe kriteret të përcaktuara sipas VKM 518/2018 “Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”<sup>21</sup>.

[20] [https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2023-07/kuadri\\_ligjor\\_dhe\\_sfdat\\_e\\_fondit\\_social.pdf](https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2023-07/kuadri_ligjor_dhe_sfdat_e_fondit_social.pdf)

[21] <https://www.sherbimisocial.gov.al/open-data/>



Në përfundim, konkludojmë se informacionet e raportuar si nga Ministria e Shëndetësië dhe Mbrojtjes Sociale apo dhe nga Shërbimi Social Shtetëror mbi mekanizmin e Fondit Social janë të reduktuara dhe nuk ndihmojnë në kryerjen e analizave të plota mbi përdorimin e tij dhe rezultatet e arritura referuar kjo dhe objektivave dhe masave të planifikuara në Planin e Veprimit për Personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2021-2025.

Lidhur me fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për qendra rezidenciale publike përgjatë periudhës 2019-2028 më poshtë paraqiten të dhënat në nivel produkti për kategorinë e PAK referuar raporteve të publikuara të monitorimit të buxhetit të MSHMS dhe dokumentave buxhetorë afatmesëm<sup>22</sup>:

**Tabela 9:** Përfitues PAK të shërbimeve të përkujdesit social të ofruar në qendrat rezidenciale publike dhe fondet buxhetore të shpenzuar dhe planifikuara përgjatë 2022-2028 në lekë

Viti	Ministria	Programi Buxhetor	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Buxheti	Sasia	Shpenzime Buxhetore
2022	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani fillestar	197	209,430,000
2022	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani i rishikuar	197	207,485,000
2022	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Fakti	198	206,070,991
2023	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani fillestar	187	222,715,000
2023	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani i rishikuar	187	251,622,000
2023	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Fakti	194	250,859,009
2024	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani fillestar	177	270,071,000
2024	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani i rishikuar	177	284,707,000
2024	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Fakti	207	284,196,551
2025	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani Fillestar	180	282,175,000
2026	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani Fillestar	160	297,138,000
2027	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani Fillestar	140	297,138,000
2028	13	Përkujdesja Sociale	91307AM	Persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë shërbime të përkujdesit	Plani Fillestar	120	297,138,000

*Burimi: Raportet e monitorimit të buxhetit të MSHMS dhe dokumentat buxhetorë afatmesëm 2025-2028*

[22] Shpenzimet e bera për periudhën 2019-2021 për kategorinë PAK nuk janë të evidentuara me një produkt më vete në raportet e monitorimit të buxhetit të publikuara nga MSHMS.



Ajo që vihet re nga të dhënat financiare të nxjerra nga raportet e buxhetit është që fondi i alokuar është rritur nga 206.07 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2022 në 284.2 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2024. Ndërkohë që numri i përfituesve rritet nga 198 në vitin 2022 në 207 përfitues në vitin 2024. Planifikimi buxhetor afatmesëm i bërë nga MSHMS shoqërohet me një reduktim të numrit të përfituesve me mesatarisht 20 vit përgjatë 2025-2028. Disagregimi i numrit të përfituesve sipas kategorive nuk është i publikuar në raportet e monitorimit të Ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen sociale. Ndërkohë që në faqen zyrtare të Shërbimit Social të Shtetëror paraqitet një informacion statistikor mbi përfituesit e shërbimeve në institucionet e përkujdesit shoqëror sipas kategorive.

**Tabela 10:** *Përfitues të shërbimeve në institucionet e përkujdesit shoqëror sipas kategorive*

SHËRBIMET REZIDENCIALE PËR TË MOSHUAR						
Institucioni	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	47	43	45	47	49	48
Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	56	58	60	60	62	67
Shtëpia e të Moshuarve Fier	56	45	48	54	53	60
Qendra polivalente për të moshuar Poliçan	37	33	27	42	44	52
Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	63	60	61	63	64	72
Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë	58	58	60	60	60	72



<b>Qendra Polivalente Ditore Kamëz</b>	28	28	27	28	27	28
<b>Qendra Ditore Polivalente Sarandë</b>	50	47	51	52	49	47
<b>NenTotali</b>	395	372	379	406	408	446

#### SHËRBIMET REZIDENCIALE PËR FËMIJË

<b>Shtëpia e Foshnjës Tiranë</b>	36	31	30	29	34	35
<b>Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë Tiranë</b>	43	39	39	37	36	35
<b>Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Korçë</b>	19	13	6	3	3	0
<b>Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Durrës</b>	18	15	18	20	21	19
<b>Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Shkodër</b>	9	18	17	17	19	18
<b>Shtëpia e Fëmijës 6-15 vjeç Shkodër</b>	35	32	21	18	24	28
<b>Shtëpi- Familje për të Rinj 16-18 vjeç Shkodër</b>	12	20	19	16	11	13



<b>Shtëpia e Fëmijës 0-5 vjeç Vlorë</b>	21	14	10	2	0	0
<b>Nen Totali</b>	229	215	187	164	172	168

#### SHËRBIMET REZIDENCIALE PËR PAK

<b>Qendra e Zhvillimit Tiranë</b>	18	19	20	16	18	23
<b>Qendra e Zhvillimit Durrës</b>	33	34	36	38	39	39
<b>Qendra e Zhvillimit Shkodër</b>	42	42	42	45	43	43
<b>Qendra e Zhvillimit Berat</b>	29	29	29	30	30	20
<b>Qendra e Zhvillimit Korçë</b>	36	36	36	36	38	38
<b>Nen Totali</b>	236	238	240	246	250	243

#### SHËRBIMET REZIDENCIALE PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

<b>QKPVT</b>	10	12	19	14	31	15
--------------	----	----	----	----	----	----



SHËRBIMET REZIDENCIALE PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE						
QKTVDHF	60	85	51	71	55	24
QENDRA EMERGJENCE						
QKTE (numër familjesh)	40	41	40	38	36	44
<b>TOTALI</b>	970	963	916	939	952	940

*Burimi: Shërbimi Social Shtetëror*

Ajo që vihet re është që të dhënat e publikuara nga Shërbimi Social Shtetëror për përfituesit e shërbimeve nga institucionet e përkujdesit që financohen nga buxheti i shtetit me ato të publikuara në raportet e monitorimit të MSHMS nuk përputhen. Nga buxheti i shtetit financohen 6 Qendra Zhvillimi për PAK dhe 2 Qendra Ditore.

Numri i përfituesve sipas SHSSH rezulton për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara në 250 përfitues ndërkohë që në raportin e monitorimit të MSHMS për vitin 2024 rezulton 207 përfitues. Sipas raportit të fundi të analizës vjetore të punës, Shërbimi Social Shtetëror raporton se rreth 50% e Qendrave të Zhvillimit të financuara nga buxheti i shtetit e kanë humbur funksionalitetin e tyre pasi përfituesit janë mbi moshën 21 vjeç dhe nuk mund të marrin asnjë zhvillim për aftësimin jetësor për shkak të diagnozës. Shërbimet që ofrohen në këto qendra janë të përqëndruara më shumë në shërbime jetësore si: ushqim, shërbim shëndetësor dhe aktivitete kulturore.

Së fundi, në zbatim të Objektivave dhe Masave të planifikuara në Planin e Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miratoi ligjin nr.65/2016 “Për ndërmarrjet sociale”. Sipas këtij ligji, ndërmarrjet sociale kontribuojnë në mbrojtjen shoqërore dhe mbështetjen e grupeve të pafavorizuara, nëpërmjet punësimit të tyre dhe ofrimit të shërbimeve për to. Në zbatim të ligjit u hartuan dhe aktet nënligjore ku përmendim miratimin e kategorive të grupeve të pafavorizuara miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.56/2018 në të cilat përfshihen dhe personat me aftësi të kufizuar.



Gjithashtu, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.174, datë 24.3.2023 “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023-2025” u miratua krijimi i fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale, të njohura si të tilla nga ministri përgjegjës për çështjet sociale, me vlerë të përgjithshme prej 240 milionë lekë për periudhën 2023–2025.

Ky fond parashikohej të alokohej përmes buxhetit të shtetit në formë subvencioni për ndërmarrjet sociale me qëllim:

*a) mbështetjen e hapjeve të vendeve të reja të punës, në pagesën e pagës minimale të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pafavorizuara;*

*b) mbështetjen në pagesën e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të ndërmarrjeve sociale, që u përkasin grupeve të pafavorizuara.*

Në raportet e monitorimit të buxhetit të MSHMS për periudhën 2020-2024 dhe dokumentat buxhetorë afatmesëm 2025-2028 është identifikuar produkti “Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërmarrjet sociale” i cili lidhet me zbatimin e detyrimeve ligjore të sipërcituara. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim historikun e shpenzimeve buxhetore të lidhura me të.





**Tabela 11:** Shpenzimet buxhetore të produktit “Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale”

Viti	Ministria	Programi Buxhetor	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Buxheti	Sasia	Shpenzime Buxhetore
2020	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani fillestar	0	42,000,000
2020	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani i rishikuar	0	0
2020	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Fakti	0	0
2021	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani fillestar	250	120,000,000
2021	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani i rishikuar	0	0
2021	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Fakti	0	0
2022	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani fillestar	200	120,000,000
2022	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani i rishikuar	0	0
2022	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Fakti	0	0
2023	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani fillestar	70	80,000,000
2023	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani i rishikuar	0	0
2023	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Fakti	0	0
2024	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani fillestar	60	80,000,000
2024	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani i rishikuar	60	28,539,856
2024	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Fakti	21	3,676,903
2025	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani Fillestar	148	80,000,000
2026	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani Fillestar	150	80,000,000
2027	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani Fillestar	150	50,000,000
2028	13	Përkujdesja Sociale	91307AG	Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërrmarjet sociale	Plani Fillestar	150	80,000,000

*Burimi: Raportet e monitorimit të buxhetit të MSHMS 2020-2024 dhe dokumentat e PBA 2025-2028*


Sikurse shihet nga MSHMS, është bërë një planifikim fillestar për zbatimin e kësaj politike në vitin 2020 duke parashikuar 42 milionë lekë për mbështetjen e punësimit të personave nga grupet e pafavorizuara në ndërrmarjet sociale, por nuk rezulton të jetë kryer shpenzimi. Ambicioz shfaqet planifikim fillestar i buxhetit dhe për periudhën 2021-2023 me respektivisht 120 milionë lekë të dedikuara për mbështetjen e planifikuar të 250 personave nga grupet e pafavorizuara përgjatë 2021-2022 dhe 80 milionë lekë të planifikuar për mbështetjen e 70 personave në vitin 2023. Por dhe gjatë këtyre viteve politika rezulton e pazbatuar. Në raportet e monitorimit të buxhetit mungojnë analizat e faktorëve që kanë penguar mos përmbushjen e kësaj politike.



Në vitin 2024, planifikimi fillestar prej 80 milionë lekësh është ri-shikuar gjatë vitit duke u reduktuar në 28.5 milionë lekë. Pavarësisht ri-shikimit në ulje, realizimi faktik i politikës rezulton i ulët me vetëm 3.7 milionë lekë ose rreth 13% ndaj buxhetit të rishikuar. Numri i përfituesve rezulton në 21 nga 60 të planifikuar.

Referuar raporteve të publikuara nuk arrijmë të analizojmë sa përfitues nga totali i përkasin kategorisë PAK pasi sipas legjislacionit të analizuar më sipër në grupet e pafavorizuara përfshihen një sërë kategorish. Në raportin e monitorimit të publikuar për vitin 2024 nga MSHMS përmendet vetëm që personave që përfshihen në financimin e këtij produkti u paguhet vlera e plotë e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi pagën minimale në Republikën e Shqipërisë. Në periudhën 2025-2028 është parashikuar që fondi të mbetet mesatarisht 80 milionë lekë ndërkohë që numri i përfituesve planifikohet në rritje me mesatarisht 150 persona.

Konkludojmë që zbatimi i politikës së punësimit të personave nga grupet e pafavorizuara në ndërmarrjet sociale ka filluar implementimin pas gati 8 vitesh nga miratimi i ligjit dhe pavarësisht kësaj rezultatet janë minimale si në terma përfituesish ashtu dhe në terma financiare. Nga MSHMS mungojnë analiza të detajuara mbi sfidat dhe arritjet në zbatimin e kësaj politike.





## **7. Shpenzimet nga buxheti i shtetit për PAK në fushën e arsimit, punësimin dhe formimin profesional**

Në fushën e arsimit, ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ka të parashikuar në dispozitat e tij që nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme. Sipas këtij ligji, arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre për t’i përgatitur për gjithëpërfshirje në shoqëri dhe në tregun e punës. Ligji parashikon si parim themeltar të tij gjithëpërfshirjen që nënkupton që përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet e arsimit special për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore.

Ligji me amendimet e fundit parashikoi transformimin e shkollave speciale në qendra burimore duke i konceptuar tashmë shkollat jo vetëm si institucione funksionale gjatë procesit mësimor por dhe përdorimin e këtyre ambjenteve dhe përtej tij, me qëllim të mbështesë arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke përmirësuar në vijimësi rezultatet e të nxënësve dhe t’i përgatisë ata për gjithëpërfshirjen dhe aftësimin për jetën, duke zhvilluar aftësitë e duhura në të gjitha fushat e përditshmërisë së tyre, sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë dhe mosdiskriminimin.

Për të përmirësuar rezultatet e të nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues. Rol të rëndësishëm kanë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore në arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Sipas ligjit, njësiat përkatëse bazë e vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojnë nxënësve me aftësi të kufizuara mjediset e përshtatshme të mësimdhënies e të të nxënësve, sipas standardeve të përcaktuara nga ministria.

Për të analizuar shpenzimet e kryera nga buxheti i shtetit për PAK në fushën e arsimit i jemi referuar raporteve të monitorimit të buxhetit të publikuar nga ministria përgjegjëse për arsimin përgjatë periudhës 2019-2024 dhe dokumentave buxhetorë afatmesëm për periudhën 2025-2028. Konstatuam që të dhënat e publikuara nga ministria në këto raporte janë të pjesshme, të paqarta dhe në disa raste dhe kontradiktore.

Konkretisht në tabelën e mëposhtme jemi përpjekur të ekstraktojmë nga hulumtimi në raportet e monitorimit të Ministrisë përgjegjëse për arsimin numrin e nxënësve me aftësi të kufizuara që trajtohen në qendrat burimore si dhe numrin total të nxënësve me AK të regjistruar në të gjitha shkollat publike. Për të analizuar dhe politikën e lidhur me mësuesit ndihmës u përpoqëm të nxjerrim dhe numrin e këtyre mësuesve nga raportet. Në disa raste të dhënat mungojnë në tabelë sepse nuk ishin raportuar dhe për pasojë analizuar në raportet e monitorimit.



**Tabela 12:** Statistika të numrit të nxënësve me AK dhe mësuesve ndihmës në shkollat publike

Kategorite perfituese	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Mesues Ndhimes ne shkollat publike	620	944	1069	Mungojne te dhenat	Mungojne te dhenat	2167
Nxenes me AK ne Qendrat Burimore	700	614	1350	Mungojne te dhenat	Mungojne te dhenat	160
Numri i nxenesve te regjistruar me AK, aftesi ndryshe,(mendore dhe fizike)	980	3658	3600	Mungojne te dhenat	1200	4600

*Burimi: Raportet e monitorimit të buxhetit vjetor të Ministrisë përgjegjëse për arsimin 2019-2024*

Sikurse shihet numri i mësuesve ndihmës ka ardhur duke u rritur në vite nga 620 mësues ndihmës në vitin 2019 në 2167 mësues në vitin 2024. Në mungesë të një produkti më vete të kostuar në raportet e monitorimit të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe referuar faktit që paga mesatare e një mësuesi në vitin 2024 ka qënë 950 euro në muaj, mund të përlogarisim afërsisht se sa është shpenzuar nga buxheti i shtetit për mësuesit ndihmës në vitin 2024 e cila rezulton në 2.34 miliardë lekë.

Nga ana tjetër raporti mësues ndihmës për nxënës me aftësi të kufizuar është përkeqësuar nga viti 2019 në të cilin ishte 1 mësues për 1.5 nxënës duke shkuar në vitin 2024 1 mësues ndihmës për 2 nxënës me AK.





Sa i përket numrit të nxënësve me AK të trajtuar në Qendrat Burimore konstatohen të dhëna kontradiktore në disa raste. Por ajo që bie në sy është reduktimi i ndjeshëm i numrit të nxënësve në vitin 2024 në 160 nxënës. Për këtë kategori nxënësish në raportet e monitorimit të ministrisë dhe dokumentat buxhetorë afatmesëm për periudhën 2025-2028 kemi evidentuar historik shpenzimesh të cilat po i paraqesim në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 13: Shpenzimet për nxënësit me aftësi të veçanta në Qendrat Burimore 2019-2028**

Viti	Ministria	Programi Buxhetor	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Buxheti	Sasia	Shpenzimet
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	700	94,609,000
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani i rishikuar	700	94,759,000
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Fakti		88,321,414
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	700	92,057,675
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani i rishikuar	700	92,057,675
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Fakti	614	81,452,565
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	1,350	90,024,916
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani i rishikuar	1,350	88,645,421
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Fakti		88,362,241
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	1,400	97,627,408
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani i rishikuar	1,400	93,467,552
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Fakti		93,418,034
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	1,200	105,808,778
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani i rishikuar	1,200	101,750,972
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Fakti		101,225,353
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	160	132,136,000
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani i rishikuar	160	121,234,128
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Fakti	160	121,164,968
2025	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	196	239,234,478
2026	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	200	239,234,478
2027	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	200	239,234,478
2028	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (përfshirë parashkollorin)	91103AH	Nxënës me aftësi të veçanta, që përfitojnë shërbim arsimor.	Plani fillestar	200	239,234,478

*Burimi: Raportet e monitorimit të buxhetit të Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe dokumentat e PBA 2025-2028*

Vihet re që shpenzimet faktike rezultojnë në rritje nga 88,3 milionë lekë në vitin 2019 në 121.16 milionë lekë në vitin 2024, ndërkohë që numri i nxënësve bie ndjeshëm në vite nga 700 në 160. Në raportet e monitorimit nuk gjejmë të analizuar performancën e këtij produkti për të thelluar më tej analizën mbi rezultatet e aktivitetit të Qendrave Burimore në jetën e përditëshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për periudhën 2025-2028 numri i nxënësve parashikohet të jetë rreth 200 dhe fondi respektiv në masën 239 milionë lekë duke rezultuar 50% më shumë se fakti i 2024. Në raportet e monitorimit përmendet që fëmijët me AK përfitojnë bursa financiare si fëmijët e tjerë në nevojë si dhe përfitojnë nga politika e teksteve mësimore falas por në mungesë të statistikave të sakta të numri të përfituesve e kemi të pamundur të përllogarisim sa shpenzohet nga buxheti i shtetit për këtë kategori. Më poshtë po paraqesim produktet e nxjerra nga raportet e monitorimit dhe dokumentat e PBA-ve të cilat lidhen me politika e sipërcituara për të evidentuar sa është shpenzuar dhe planifikuar në total për to në vite.

**Tabela14: Shpenzime për fëmijët në nevojë dhe nxënësit që përfitojnë tekste shkollore falas 2019-2028**

Viti	Ministria	Programi Buxhetor	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Buxheti	Sasia	Shpenzimet
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	700	94,609,000
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani i rishikuar	700	55,739,700
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Fakti		44,739,580
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	190,000	585,000,000
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani i rishikuar	190,000	505,000,000
2019	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Fakti		501,314,982
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	700	143,421,000
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani i rishikuar	700	107,733,981
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Fakti	940	81,385,657
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	198,000	500,000,000
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani i rishikuar	198,000	594,123,513
2020	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Fakti	231,840	590,045,360
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	1,350	153,423,260
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani i rishikuar	1,350	120,015,388
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Fakti		106,651,844
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	254,000	700,000,000
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani i rishikuar	254,000	966,968,283
2021	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Fakti		964,547,990
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	1,800	210,005,986
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani i rishikuar	1,800	192,536,182
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Fakti		169,542,030
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	260,000	900,000,000
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani i rishikuar	260,000	799,626,599
2022	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Fakti		799,411,146
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	2,000	253,196,000
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani i rishikuar	2,000	231,174,010
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Fakti		217,121,885
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	260,000	1,000,000,000
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani i rishikuar	260,000	1,000,000,000
2023	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Fakti		989,049,249
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	4,000	417,600,000
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani i rishikuar	4,000	310,392,071
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Fakti	4,000	263,115,699
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	252,000	800,000,000
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani i rishikuar	228,833	1,042,305,162
2024	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Fakti	228,833	1,041,249,179
2025	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	4,250	280,000,000
2026	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	4,000	270,000,000
2027	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	4,550	320,000,000
2028	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AC	Femije ne nevojë që përfitojnë shërbim arsimor cilesor.	Plani fillestar	4,750	330,000,000
2025	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	225,000	900,000,000
2026	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	225,000	900,000,000
2027	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	220,000	900,000,000
2028	Ministria e Arsimit	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	91103AG	Nxenes perfitues te teksteve shkollore falas per arsimin 9-vjeçar.	Plani fillestar	215,000	900,000,000



Së fundi, nga analiza e shpenzimeve në programin buxhetor të arsimit të lartë me qëllim identifikimin e numrit të studentëve me AK që përfitojnë bursa për shkak të statusit të tyre dhe fondet përkatëse nuk gjetëm të dhëna të dedikuara për këtë qëllim.

Lidhur me mbështetjen e infrastrukturës shkollore nga Njësitë e vetëqeverisjes Vendore në drejtim të lehtësimit të aksesit mungon informacioni apo analizat në raportet e monitorimit mbi shpenzimet e realizuara për këtë qëllim.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm i planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2021-2025 është dhe punësimi dhe formimi profesional i tyre. Legjislacioni i fushës që rregullon punësimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij kanë të rregulluar në mënyrë të përshtatshme procesin e punësimit dhe formimit profesional për personat me aftësi të kufizuara. Në ligjin nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar është vendosur detyrimi që çdo punëdhënës duhet të punësojë:

*a) një person që i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes; dhe*

*b) nga një person shtesë, po nga kjo kategori, për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronja “a” të sipërcituar.*

Në rast se nuk realizohet punësimi, punëdhënësi derdhet një kontribut për llogari të Fondit Social të punësimit në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi për çdo muaj për çdo person që i përket kategorisë PAK. Të ardhurat dhe kontributet për llogari të Fondit derdhen tek institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë (AKPA) dhe janë zë më vete në buxhetin e saj.

Fondi Social i Punësimit i papërdorur në vitin korrent mbartet në vitin buxhetor pasardhës me përjashtim të të ardhurave nga buxheti i shtetit. Fondi Social i punësimit përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, rikonstrukcion dhe përshtatje të vendit të punës të personave me aftësi të kufizuara.

Nga analiza e realizuar nga ana jonë në raportet e monitorimit të buxhetit të ministrisë përgjegjëse për punësimin dhe aftësimin profesional nuk arritëm të identifikonim asnjë produkt apo tregues performance të dedikuar për punësimin apo aftësimin profesional nga programet aktive të nxitjes së punësimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Si rezultat, analizuam buletinet statistikore dhe analizat vjetore të punës të publikuara nga Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive. Të dhënat e publikuara në këto raporte janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme.



**Tabela 15:** Statistika të numrit të punëkërkesve të papunë të regjistruar sipas nivelit arsimor dhe gjinisë

	2019	2020	2021	2022
<b>Punëkërkes të Papunë PAK të</b>	542	604	475	237
<b>Niveli Arsimor</b>				
Arsimi Bazë	49%	46%	49.80%	74.50%
Arsimi I Mesëm	31%	33%	30.70%	14.50%
Arsimi i Lartë	6%	6%	6.20%	5.50%
<b>Të punësuar nga kategoria PAK</b>	82	49	32	18
Femra	21	19	10	1
Meshkuj	61	30	22	17

*Burimi: Buletinet Statistikore AKPA 2019-2022*

Sikurse shihet nga të dhënat e publikuara, numri i punëkërkesve të papunë nga kategoria PAK që janë regjistruar pranë zyrave të punës rezulton në rënie ku në vitin 2022 ky numër ishte 237 gati 50% më pak se ato të regjistruar në vitin 2019. Niveli arsimor i punëkërkesve të papunë nga kategoria PAK që i drejtohen zyrat të punës për të marrë një ofertë punësimi është i mbizotëruar nga personat me arsim bazë të cilët përbëjnë mesatarisht përgjatë periudhës rreth 55% të totalit. Rreth 6% e personave PAK që regjistrohen si punëkërkesve të papunë zotërojnë arsimin e lartë dhe rreth 30% e tyre kanë të paktën arsimin e mesëm të përgjithshëm ose atë profesional. Sa i përket gjinisë së personave PAK të regjistruar dhe punësuar prevalojnë meshkujt kundrejt femrave. Ajo që bie në sy është që numri i personave PAK të punësuar krahasuar me totalin e personave të regjistruar nga kjo kategori është shumë i ulët me një trend rënës nga 82 të punësuar në vitin 2019 në vetëm 18 të punësuar në vitin 2022. Ky trend dëshmon që politikat e ndërmarra për nxitjen e punësimit të kësaj kategorie nuk kanë dhënë rezultatet e pritura.

Sa i përket shpërndarjes sipas llojeve të programeve të nxitjes së punësimit të financuara nga buxheti i shtetit në tabelën e mëposhtme paraqitet në terma krahasimor numri total i përfituesve, numri i përfituesve PAK dhe fondet totale buxhetore të shpenzuara për çdo program të nxitjes së punësimit. Në kushtet kur nuk kemi të disagreguar shpenzimet financiare sipas kategorive, kemi përlogaritur në mënyrë përpjestimore fondet e alokuara përgjatë 2019-2022 nga buxheti i shtetit në mbështetje të punësimit për kategorinë PAK.



**Tabela 16:** Punëkërkuesit përfitues nga programet e nxitjes së punësimit dhe fondet buxhetore të shpenzuara

Pu-Pa përfitues nga programet e nxitjes së punësimit	2019			2020			2021			Viti 2022			Viti 2023		
	Total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar sipas programeve	Total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar sipas programeve	Total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar sipas programeve	Total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar sipas programeve	Total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar sipas programeve
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	26	1	3 228 939	341	14	510 963	484	28	51 154 883	523	31	43 881 595	405	36	61 600 000
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	1143	60	101 961 788	273	0	2 221 986	417	1	53 762 691	338	1	35 366 947	183	0	18 300 000
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	1282	1	183 825 400	491	7	1 279 678	1 086	15	66 826 265	929	9	59 201 995	633	4	37 600 000
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	0	0	16 008	30	2	606 265	282	2	19 795 076	20	0	1 769 204	0	0	0
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	20	0	2 660 245	1 129	1	26 381 493	1 496	7	139 302 685	515	2	69 152 176	51	0	2 800 000
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	58	0	11 960 888	536	1	792 957	816	3	36 474 561	466	0	35 480 789	133	0	8 600 000
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	1378	12	49 717 406	717	5	26 784 626	208	0	1 197 597	1 267	4	144 548 212	995	0	264 300 000
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	1430	37	21 766 031	602	37	11 854 181	45	1	20 624 270	286	1	58 799 065	235	0	59 100 000
<b>TOTALI</b>	<b>5337</b>	<b>111</b>	<b>374 736 665</b>	<b>4119</b>	<b>67</b>	<b>70 431 549</b>	<b>4 834</b>	<b>57</b>	<b>389 138 028</b>	<b>4 344</b>	<b>48</b>	<b>448 193 983</b>	<b>2 635</b>	<b>40</b>	<b>448 300 000</b>

Burimi: Buletinet Statistikore AKPA 2019-2023

Punëkërkuesit e punësuar nga kategoria PAK kryesisht kanë përfituar nga programi 1 i punësimit, nga programi 3 i praktikave të punës dhe nga programi i vetëpunësimit. Konstatohet që numri i përfituesve nga programet e nxitjes së punësimit rezulton në rënie nga viti 2019 ku ishte 111 përfitues PAK në vetëm 40 përfitues PAK në vitin 2023. Fondet buxhetore të alokuara për këtë kategori dhe përpjesa e tyre ndaj totalit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 17:** Fondet e shpenzuara nga buxheti i shtetit për kategoritë PAK

	2019	2020	2021	2022	2023
<b>Pu-Pa përfitues nga programet e nxitjes së punësimit</b>	<b>Fonde e shpenzuara per kategorine PAK</b>	<b>Pu-Pa përfitues nga programet e nxitjes së punësimit</b>	<b>Pu-Pa përfitues nga programet e nxitjes së punësimit</b>	<b>Pu-Pa përfitues nga programet e nxitjes së punësimit</b>	<b>Pu-Pa përfitues nga programet e nxitjes së punësimit</b>
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	124 189	20 953	2 959 373	2 601 012	5 475 556
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	5 352 324	0	128 927	104 636	0
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	143 390	18 244	923 015	573 539	237 599
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	0	40 418	140 391	0	0
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	0	23 367	651 817	268 552	0
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	0	1 479	134 098	0	0
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	432 953	186 783	0	456 348	0
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	563 177	728 579	458 317	205 570	0
<b>TOTALI</b>	<b>6 616 032</b>	<b>1 019 823</b>	<b>5 395 938</b>	<b>4 209 658</b>	<b>5 713 154</b>
<b>Perpjesa ndaj totalit</b>	<b>2%</b>	<b>1%</b>	<b>1%</b>	<b>1%</b>	<b>1%</b>

Burimi: Buletinet Statistikore AKPA 2019-2023

Sikurse shihet nga përlllogaritjet e bëra fondet e shpenzuara nga buxheti i shtetit për kategorinë PAK në fushën e nxitjes së punësimit zënë vetëm 1% të fondeve totale të shpenzuara për këtë politikë. Ky trend mbetet i qëndrueshëm në vite duke dëshmuar që politikat për nxitjen e punësimit kanë ndikuar pak në përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri.



**Tabela 18:** Punëkërkuessit që përfitojnë nga programe e formimit profesional

Programet e Formimit Profesional	2019			2020			2021			2022		
	Nr total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar nga buxheti i shtetit	Nr total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar nga buxheti i shtetit	Nr total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar nga buxheti i shtetit	Nr total	Kategoria PAK	Fondi i shpenzuar nga buxheti i shtetit
Punëkërkuessit të Papunë që përfitojnë kurse pa pagesë	8 714	110	280 000 000	5 532	56	282 000 000	6 631	95	295 000 000	9 398	83	331 000 000
Fondet e shpenzuara nga buxheti për kategorinë PAK			3 534 542			2 854 664			4 226 361			2 923 282

Burimi: Buletinet Statistikore AKPA 2019-2023

Lidhur me punëkërkuessit e papunë që përfitojnë nga programet e formimit profesional, në raportet e publikuara nga AKPA citohet që personat nga kategoria PAK përfitojnë nga kurset pa pagesë të formimit profesional. Numri i përfituesve dhe në këtë program ka rezultuar në rënie në vite duke u reduktuar nga 110 përfitues në vitin 2019 në 83 përfitues në vitin 2022. Fondet e alokuara nga buxheti i shtetit për këto programe dhe përdorimi i tyre raportohet nga AKPA i plotë, pra i pa ndarë sipas kategorive përfituese. Si rezultat, kemi nxjerrë në mënyrë përpjestimore mbështetur në numrin e përfituesve. Fondet e alokuara përsëri rezultojnë të pakta krahasuar me totalin duke përbërë mesatarisht 1% të tyre.

Së fundi, lidhur me zbatimin e detyrimeve të ligjit për nxitjen e punësimit, për punësimin e personave PAK ose derdhjen e kontributeve në masën e pages minimale tek Fondi Social i punësimit, kemi konstatuar që raportimet për ngritjen dhe vënien në funksionim të tij janë bërë në analizën e punës së AKPA-s në vitin 2023, pra rreth 4 vite pas miratimit të ligjit. Në dokumentat buxhetorë afatmesëm dhe raportet e monitorimit të buxhetit të ministrisë përgjegjëse për punësimin nuk raportohet asnjë informacion mbi zbatimin e detyrimeve të ligjit, ngritjen e fondit dhe aktivitetet e realizuara prej tij. Përveç hartimi të akteve nënligjore në zbatim të ligjit mungon tërësisht informacioni mbi masën e fondit të krijuar dhe si përdoret ai për të arritur qëllimet e ligjit.

Në analizën e vitit 2023, AKPA përmend masa të ndërmarra në drejtim të zhvillimit të takimeve me disa kategori biznesesh për këtë qëllim si dhe faktin që është ngritur një sistem për regjistrimin e punëkërkuessve nga kategoria PAK që rezultojnë 8000, por nuk përmend asgjë mbi zbatimin në praktikë të kësaj politike nga bizneset dhe administrata publike. Mungesa e transparencës ngre dyshime mbi zbatimin e ligjit dhe arritjen e objektivave të planit të veprimit për PAK për periudhën 2021-2025.



## 8. Shpenzimet nga buxheti i shtetit për PAK në fushën e aksesueshmërisë në infrastrukturën publike dhe transportin rrugor

Aksesueshmëria në infrastrukturën publike dhe transportin rrugor mbetet një nga objektivat më të rëndësishëm të planit të veprimit të personave me aftësi të kufizuara për periudhën 2021-2025. Kështu nëse i referohemi planit të veprimit, objektivat dhe buxheti i planifikuar për përmbushjen e tyre rezultojnë në masën totale 289,5 milionë lekë për periudhën 2021-2025 dhe përbëjnë rreth 19% të kostos totale të planit.

**Tabela 19: Objektivi 1 dhe kostoja e tij**

OBJEKTIVI 1	2021	2022	2023	2024	2025	2025
1.1 Realizimi i aksesueshmërisë në mjedise për personat me aftësi të kufizuara	3 858 608	18 529 984	16 479 128	16 998 728	20 251 704	76 118 152
1.2 Realizimi i aksesueshmërisë në transport për personat me aftësi të kufizuara	8 445 300	40 268 708	20 728 900	20 668 260	18 301 540	108 412 708
1.3 Realizimi i aksesueshmërisë në informacion dhe në komunikim për personat me aftësi të kufizuara	14 947 232	29 175 500	15 209 768	9 271 344	36 340 500	104 944 344
<b>TOTALI</b>	<b>27 251 140</b>	<b>87 974 192</b>	<b>52 417 796</b>	<b>46 938 332</b>	<b>74 893 744</b>	<b>289 475 204</b>

### *Burimi: Plani i Veprimit të PAK 2021-2025*

Për të analizuar përmbushjen e objektivave të lidhur me këtë fushë analizuam raportet e monitorimit të Ministrisë përgjegjëse për transportin për të identifikuar nëse ka në buxhetet e tyre afatmesme produkte apo tregues performance të cilat synojnë të masin rezultatet konkrete në përmbushjen e masave dhe aktiviteteve të planit të veprimit në këtë fushë. Informacionet e paraqitura në këto raporte nuk kishin të dhëna në terma financiare dhe jo financiare për aksesueshmërinë në fushën e transportin rrugor për personat PAK. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën nuk i është përgjigjur kërkesës sonë për informacion mbi këtë çështje. Ndërkohë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është hartuar një auditim performance me temë “Raport Përfundimtar i Auditimit të Performancës “Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara”. Në këtë raport konkludohet si vijon:

“Megjithëse kuadri ligjor dhe strategjik në Shqipëri njih të drejtën për akses dhe jetë të pavarur të personave me aftësi të kufizuara (PAK), në praktikë nuk janë krijuar ende kushte të përshtatshme për realizimin e kësaj të drejte. Auditimi tregoi se, zbatimi i masave të PKPAK 2021 - 2025 është i pjesshëm dhe i fragmentuar. MSHMS, MIE, Bashkitë Shkodër, Durrës dhe Pogradec nuk kanë siguruar një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe funksional në këtë drejtim. Situata paraqitet problematike në fushën e transportit rrugor publik dhe infrastrukturës. Bashkitë e audituara nuk kanë miratuar plane të posaçme për aksesueshmërinë, nuk kanë kryer monitorime sistematike të kushteve ekzistuese dhe nuk kanë zbatuar kriteret për aksesueshmëri në projektimin dhe inspektimin të ndërtimeve të reja.



Kuadri ligjor aktual nuk përcakton nivelin minimal të aksesueshmërisë së garantuar në transportin rrugor publik. Për më tepër, legjislacioni kombëtar nuk është i përafuar me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e transportit të aksesueshëm. Në mungesë të ndërhyrjeve të strukturuar, mekanizmave funksionalë të bashkëpunimit dhe mbështetjes së qëndrueshme teknike e financiare, PAK vazhdojnë të përballen me barriera serioze në qasje dhe pjesëmarrje të barabartë në jetën publike, duke u penguar të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe dinjitoze.”<sup>23</sup>

Ndërkohë lidhur me aksesueshmërinë në informacion, referuar dhe parashikimeve në planin e veprimit i jemi drejtuar AKSHI-t për të na raportuar mbi masat e marra në drejtim të adaptimit të të gjitha sistemeve në përdorim nga publiku për të qënë të aksesueshme dhe nga kategoria PAK, pasi referuar dokumentave të planifikimit buxhetor afatmesëm dhe raporteve të monitorimit nuk kemi gjetur informacion të detajuar në këtë drejtim. Nga AKSHI jemi informuar si vijon:

“Në kuadër të projektit “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit GOVTECH” (<https://akshi.gov.al/programi-govtech/>), që është pjesë e angazhimeve tona për përmirësimin dhe digjitalizimin e shërbimeve publike, janë parashikuar investime të konsiderueshme për të siguruar që edhe personat me aftësi të kufizuara të mund të përdorin me lehtësi dhe pa pengesa platformën e-Albania. Ky projekt, i cili është ende në proces synon integrimin e standardeve ndërkombëtare të aksesueshmërisë, në mënyrë që të gjithë qytetarët, pavarësisht nga ndonjë kufizim fizik apo aftësi të tjera, të mund të përfitojnë një shërbim të barabartë dhe efikas. Ju bëjmë me dije se shumë shpejt, nëpërmjet e-Albania 2.0 do të mundësohen shërbime lehtësisht të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, ndërkohë që aktualisht asistentja virtuale Diella ofron ndihmë në kohë reale me zë dhe figurë për çdo pyetje që përdoruesit kanë për shërbimet e portalit.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se AKSHI ka përfunduar draftin për projektvendimin: “Mbi aksesimin e faqeve të internetit dhe aplikacioneve celulare të organeve të sektorit publik”. Ky vendim është përafuar pjesërisht me Direktivën (BE) 2016/2102 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 26 tetor 2016: “Mbi Aksesin e Faqeve Zyrtare të Internetit dhe Aplikacioneve Celulare të Organeve të Sektorit Publik”, ku parashikohet përdorimi i ECAG 2.0 , rregulla që mundësojnë aksesin në internet dhe aplikacione celulare, për personat me aftësi të kufizuara në të gjithë sektorin publik. Ky projektvendim pritet të miratohet brenda vitit 2026.”

Sikurse mund të analizohet dhe nga përgjigjia e AKSHI-t nuk është realizuar asnjë nga masat e planit të veprimit për PAK deri tani dhe masat për të adaptuar sistemet si e-albania etj parashikohen të bëhen në vitin 2026.

[23] Kontrolli i Lartë i Shtetit, Raport Auditimi Performance “Aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara”, faqe 15, <https://www.klsh.org.al/wp-content/uploads/2025/11/Raport-Aksesueshmëria-PAK-web.pdf>



## 9. Shpenzimet nga buxheti i shtetit për PAK në fushën e aksesit në drejtësi

Ofrimi i ndihmës juridike falas në Shqipëri rregullohet mbështetur në Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili njeh PAK si kategori prioritare për përfitimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Legjislacioni plotësohet dhe përmes dokumentit të Strategjinë Kombëtare për Aftësinë e Kufizuar 2021–2025, që thekson domosdoshmërinë e qasjes në drejtësi pa barriera. Sipas PKPAK 2021 – 2025, Qëllimi i politikës 2 “Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara”, është një nga masat e rëndësishme për t’u zbatuar me një buxhet total të planifikuar për periudhën prej 204 milionë lekë ose rreth 14.6% të totalit të kostos totale të të planit të veprimit.

Nën këtë qëllim, janë përcaktuar 2 objektiva specifike të rëndësishme të cilët kanë të bëjnë me rritjen e numrit të individëve me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas si dhe njohja e barabartë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të personave me aftësi të kufizuara mendore.

Për të gjurmuar të dhëna financiare lidhur me realizimin e këtij qëllimi dhe objektivave specifike të tij, ju referuam të dhënave të raporteve të monitorimit të Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën buxhetohet në Programin Buxhetor “Ndihma Juridike”, aktiviteti i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si institucioni përgjegjës për administrimin e sistemit të ndihmës juridike falas, bazuar në nenin 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në zbatim të detyrave të saj funksionale, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike falas.

Më poshtë po paraqesim buxhetin e shpenzuar dhe planifikuar për programin e “Ndihmës Juridike” përgjatë periudhës 2019-2028.

**Tabela 20:** Buxheti i shpenzuar dhe planifikuar për periudhën 2019-2028 për Ndihmën Juridike

Buxheti në vite në mln le	Fakti 2019	Fakti 2020	Fakti 2021	Fakti 2022	Fakti 2023	Fakti 2024	Buxheti 2025	Buxheti 2026	Buxheti 2027	Buxheti 2028
Buxheti i Programit "Ndihma Juridike"	16.3	17.2	29.7	36.8	51.2	66.9	103.5	132.5	132.7	133.1
Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë	10,732.7	8,550.6	7,951.9	8,328.4	11,053.0	13,930.3	14,930.3	14,963.8	14,925.9	15,148.9
Pesha në përqindje	0.15%	0.20%	0.37%	0.44%	0.46%	0.48%	0.69%	0.89%	0.89%	0.88%

*Burimi: Raportet e monitorimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Dokumentat Buxhetor Afatmesëm 2025-2028*



Sikurse shihet nga tabela e mësipërme buxheti i programit buxhetor të Ndhmës Juridike është rritur nga viti 2019 në vitin 2024 me gati 4-fish më shumë. Buxheti i programit dhe periudhën 2025-2028 është planifikuar në rritje gjë që dëshmon angazhimin për të fuqizuar këtë funksion. Me më shumë fonde, përkthehet në hapje ev më shumë qendrave të ndihmës juridike, duke e sjellë shërbimin më afër individëve. Për kategorinë PAK, që përfitojnë nga ndihma juridike falas kjo do të thotë më pak shpenzime transporti; më shumë mundësi për këshillim falas dhe më shumë mundësi për përfaqësim në gjykata dhe përballimin e procedurave administrative. Pavarësisht kësaj, në këto raporte nuk gjetëm të dhëna financiare të disagreguara për kategorinë PAK, në terma përfituesish dhe terma financiare për të analizuar më tej se si ka evoluar mbështetja e kësaj kategorie nga buxheti i shtetit. Nga raportimi i bërë në formë shkresore nga Ministria e Drejtësisë, rezulton se për periudhën 2019-2025, 2337 individë me aftësi të kufizuara kanë përfituar ndihmë juridike parësore për këtë periudhë dhe 1034 individë me aftësi të kufizuara kanë përfituar ndihmë juridike dytësore.

Sa i përket njohjes së barabartë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të personave me aftësi të kufizuara mendore, përveç hartimit dhe miratimit të legjislacionit parësor ku përmendim Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e PAK, Ligjin për Shëndetin Mendor, dispozitat në Kodet civile dhe penale lidhur me kapacitetin juridik dhe rregullat zgjedhore që garantojnë pjesëmarrjen politike, në raportet e monitorimit të Ministrive dhe Institucioneve Qendrore dhe dokumentave buxhetorë afatmesëm nuk gjejmë të dhëna specifike mbi masat e marra dhe fondet e shpenzuara për këtë qëllim.

